



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 47

Qershor

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.473, datë 23.6.2005	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Serbisë dhe Malit të Zi, për bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik.....	3
Vendim i KM nr.478, datë 23.6.2005	Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të disa ndërmarrjeve publike.....	5
Vendim i KM nr.479, datë 23.6.2005	Për lirimimin dhe emërimin në detyrë të një anëtari të Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive.....	6
Vendim i KM nr.482, datë 30.6.2005	Për lirim nga detyra	7
Vendim i KM nr.484, datë 30.6.2005	Për miratimin e letërpolitikave dhe të planit të veprimit për kontrollin e brendshëm financiar, publik.....	7

VENDIM
Nr.473, datë 23.6.2005

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË SERBISË DHE MALIT TË ZI, PËR BASHKËPUNIMIN TREGTAR DHE EKONOMIK.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Serbisë dhe Malit të Zi, për bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE

MBI BASHKËPUNIMIN TREGTAR DHE EKONOMIK NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË SERBISË DHE MALIT TË ZI

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave të Serbisë dhe Malit të Zi, më poshtë referuar si "Palë Kontraktuese",

duke marrë në konsideratë rëndësinë e marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike midis Palëve Kontraktuese,

të shtyrë nga vullneti i përbashkët për zhvillimin e marrëdhënieve me interes të ndërsjellë dhe mirëkuptimit,

duke kuptuar nevojën e adoptimit të praktikave standarde të tregut ndërkombëtar dhe zgjerimin e marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët Kontraktuese do të nxisin, mbështesin dhe lehtësojnë zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik ndërmjet tyre në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, ligjet e zbatueshme dhe normat e tyre.

Neni 2

Palët Kontraktuese, brenda përgjegjësisë së tyre, do të bëjnë përpjekje për të siguruar kushte të qëndrueshme për zhvillimin e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik ndërmjet tyre, duke u përqendruar në veçanti në bashkëpunimin ekonomik në fusha të tilla, si bankë, industri, teknikë, shkencë dhe teknologji.

Neni 3

Në lidhje me zhvillimin e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik, Palët Kontraktuese do të nxisin shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit, veçanërisht lidhur me legjislacionin dhe programet ekonomike të tyre, si dhe çdo informacion tjetër me interes të ndërsjellë.

Neni 4

1. Të gjitha pagesat për mallrat e tregtuara ndërmjet personave juridikë dhe/ose fizikë (këtu më poshtë të referuara si ente) të dyja Palët Kontraktuese do t'i kryejnë në monedha lehtësisht të konvertueshme.

2. Në interes të lehtësimit të zhvillimit të bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik, Palët Kontraktuese nuk do të pengojë shkëmbimin e mallrave midis enteve të tyre në bazë të marrëveshjeve tregtare me kompesim, barter apo kontrata të tjera, në përputhje me normat logjore të tyre.

Neni 5

Palët Kontraktuese, në përputhje me ligjet dhe normat e tyre respektive, do t'i japin njëra-tjetrës ndihmë në organizimin e panairove, ekspozitave të specializuara dhe aktiviteteve nxitëse.

Neni 6

1. Me qëllim zbatimin e objektivave të kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese kanë rënë dakord që të ngrenë një komision të përbashkët shqiptaro-serbomalazez të përbërë nga përfaqësues të të dyja Palëve Kontraktuese.

2. Komisioni i përbashkët do të takohet çdo vit, ose kur është e nevojshme, me kërkesë të ndonjëres Palë Kontraktuese, në mënyrë alternative në shtetet e secilës Palë Kontraktuese.

3. Me synim nxitjen dhe zgjerimin e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik ndërmjet tyre, Komisioni i Përbashkët do të përqendrohet në sa më poshtë:

a) do të marrë parasysh rrugët dhe mënyrat për nxitjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik ndërmjet Palëve Kontraktuese;

b) do të monitorojë progresin në zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe të përfunduara ndërmjet tyre lidhur me bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik dhe do të rekomandojë zgjidhje për probleme të cilat mund të kenë lindur nga zbatimi i këtyre marrëveshjeve;

c) do të identifikojë fushat për të kontribuar në zhvillimin e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik dhe do t'i paraqesë ato tek organet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese;

d) do të identifikojë problemet që vështirësojnë bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik dypalësh dhe të rekomandojë masa për zgjidhjen e këtyre problemeve.

4. Komisioni i përbashkët mund të miratojë normat e veta procedurale.

Neni 7

Kjo marrëveshje nuk do të cenojë marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara dhe të zbatuara nga Palët Kontraktuese.

Neni 8

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese, lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet me konsultime apo bisedime nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 9

1. Palët Kontraktuese do të kenë të drejtën të ndryshojnë çdo depozitë të kësaj Marrëveshjeje.

2. Çdo ndryshim ose dhënie fund e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojë në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e përfunduara ndërmjet enteve ekonomike të Palëve Kontraktuese gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj.

Neni 10

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 ditë nga dita e marrjes së njoftimeve të fundit të shkëmbyera nga Palët Kontraktuese që dëshmojnë se të gjitha kërkesat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të saj janë përmbushur.

Kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi për një periudhë 1 vjeçare e do të shtyhet automatikisht për një periudhë të mëtejshme njëvjeçare, nëse njëra prej Palëve-Kontraktuese nuk njofton me shkrim Palën tjetër Kontraktuese se i jep fund kësaj Marrëveshjeje. Në këtë rast Marrëveshja pushon së qeni në fuqi tre muaj pas marrjes së këtij njoftimi.

Bërë në Beograd, më 23 maj 2005 në dy origjinale në gjuhët shqip, serbisht dhe anglisht, me tekste njëllorj autentike. Në rast kontradikte në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

VENDIM
Nr.478, datë 23.6.2005

PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË DISA NDËRMARRJEVE
PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të viti 2005”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, t’i shtohet fondi prej 308 800 000 (treqind e tetë milionë e tetëqind mijë) lekësh, i cili të përdoret si më poshtë vijon:

a) 201 097 000 (dyqind e një milion e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ndaj KESH sh.a.-së, nga:

- Kombinati Energjetik, Elbasan, 131 935 000 (njëqind e tridhjetë e një milion e nëntëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë,

- Albakrom, sh.a.-ja, 69 162 000 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë.

b) 107 703 000 (njëqind milionë e shtatëqind e tre mijë) lekë, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, nga Albakër, sh.a., ndaj:

- KESH sh.a.-së, 43 000 000 (dyzet e tre milionë) lekë,

- Institutit të Sigurimeve Shoqërore, 64 703 000 (gjashtëdhjetë e katër milionë e shtatëqind e tre mijë) lekë.

KESH sh.a.-ja, shumën prej 43 000 000 (dyzet e tre milionë) lekësh, ta përdorë për të shlyer detyrimet e prapambetura ndaj Armo, sh.a.-së, dhe Armo sh.a.-ja, të njëjtën shumë, ta përdorë për të shlyer detyrimet e prapambetura ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

2.Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, t’i shtohet fondi prej 91 200 000 (nëntëdhjetë e një milion e dyqind mijë) lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ndërmarrjeve të ujësjellësve ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Këto fonde të përballohen nga fondi i kontingjencës, i planifikuar për vitin 2005.

4. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E SHA UJËSJELLËS- KANALIZIME DEBITORE NDAJ INSTITUTIT TË SIGURIMEVE
SHOQËRORE

Nr.	Emërtimi	Shuma e detyrimeve
1	Sh.a. ujësjellës- kanalizime Fushë Krujë	2170
2	Sh.a. ujësjellës Rrogozhinë	611
3	Sh.a. ujësjellës- kanalizime Fier	2805

4	Sh.a. ujësjellësi Patos	10 000
5	Sh.a. ujësjellësi Ballsh	10 000
6	Sh.a. ujësjellësi Novoselë	1684
7	Sh.a. ujësjellësi Korçë Fshat	1969
8	Sh.a. ujësjellësi Peqin	4000
9	Sh.a. ujësjellësi Elbasan Fshat	5000
10	Sh.a. ujësjellësi Berat	5000
11	Sh.a. ujësjellësi Kuçovë	5000
12	Sh.a. ujësjellësi Poliçan	5000
13	Sh.a. ujësjellësi Lushnjë Fshat	5000
14	Sh.a. ujësjellës- kanalizime Lezhë	5000
15	Sh.a. ujësjellësi Vau i Dejës	333
16	Sh.a. ujësjellësi Bulqizë	2322
17	Sh.a. ujësjellësi Krastë	2827
18	Sh.a. ujësjellësi Laç	3231
19	Sh.a. ujësjellësi Gjirokastër Fshat	2766
20	Sh.a. ujësjellësi Gjirokastër Qytet	2666
21	Sh.a. ujësjellësi Libohovë	761
22	Sh.a. ujësjellësi Mat	1055
23	Sh.a. ujësjellësi Shkodër Qytet	10 000
24	Sh.a. ujësjellësi Rrëshen	2000
	Shuma	91 200

VENDIM
Nr.479, datë 23.6.2005

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË NJË ANËTARI TË KËSHILLIT
MBIKËQYRËS TË AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KREDIVE

Në mbështetje të nenit 114 të Kushtetutës dhe të neneve 11 e 12 të ligjit nr.8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Arben Hoti, anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive, lirohet nga kjo detyrë.
2. Znj. Merita Xhafaj, emërohet anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.482, datë 30.6.2005

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Zoti Shpëtim Idrizi, Drejtor i Përgjithshëm i Doganave, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.484, datë 30.6.2005

**PËR MIRATIMIN E LETËRPOLITIKAVE DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR
KONTROLLIN E BRENDSHËM FINANCIAR, PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, pika 2 të nenit 12 të ligjit nr.9009, datë 13.2.2003 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e letërpolitikave për kontrollin e brendshëm financiar, publik dhe të planit të veprimit për zbatimin e tyre.
 2. Ministritë përgjegjëse, sipas përcaktimeve të bëra në planin e veprimit, të paraqesin në Këshillin e Ministrave aktet ligjore për miratim.
 3. Ministri i Financave, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, t'i paraqesë Kryeministrit, propozimet për pozicionin, strukturën dhe përshkrimin funksional të Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Metodologjisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

1.Hyrje,qellimi.

Qellimi i ketij materiali eshte te zhvilloje nje projekt te ri per sistemin e kontrollit te brendshem financiar publik (KBFP), duke e finalizuar ate me hartimin e nje dokumenti perfundimtar,pergaditjen e nje plani veprimi dhe nje seri aktesh te tjera ligjore, nenligjore dhe metodologjike ne zbatim te tij si dhe percaktimin e organizimeve dhe instrumentave per zbatimin e tij.

Leter politikat synojne te percaktojne drejtimet me kryesore dhe detyrimet e strukturave publike, ne nivel qendror dhe lokal, per te permiresuar perdorimin e burimeve publike me dobi,kursim dhe frytshmeri, si dhe ne kete kuader, te synoje drejtimet dhe mekanizmat per percaktimin e pergjegjesive te tyre.

Kontrolli i brendshem financiar publik: *eshte organizimi, politikat dhe procedurat e perdorura per te ndihmuar dhe per te siguruar drejtuesit, se programet e tyre po arrijne rezultatet e synuara, se burimet e perdorura per te realizuar keto programe jane ne perputhje me qellimet dhe objektivat e subjektit publik, se programet e tyre jane te mbrojtura nga mashtrimet, harxhimet dhe keqmenaxhimet, dhe se informacion i besueshem dhe kohore eshte perftuar, ruajtur, raportuar dhe perdorur per vendimmarrjen.* Nga ana tjeter kontrolli i brendshem duhet te garantoje ne menyre te arsyeshme se programet sigurojne qe burimet publike jane hartuar ne menyre te tille qe garantojne perdorimin e burimeve me dobi,kursim dhe frytshmeri.

Per te realizuar funksionet e mesiperme eshte e domosdoshme te adoptohen pervoja me te mira te vendeve te BE si dhe standartet nderkombetare te pranuar ne kete fushë.

Projekti synon te marre ne konsiderate kushtet specifike te vendit tone ne tranzicion duke i pare ato ne zhvillim dhe progresin e tyre te shpejte. Ai gjithashtu synon te jete ne harmoni me Kushtetuten, standartet nderkombetare dhe legjislacionin ne fuqi, strukturen e Qeverise dhe funksionet e hallkave te ndryshme te administrates publike dhe te pushtetit vendor si dhe me flukset e punes dhe problematikat qe ato paraqesin.

2.Kerkesa te pergjitheshme per krijimin dhe implementimin e sistemit te kontrollit brendshem financiar publik.

Zhvillimi i nje sistemi te KBFP sipas standarteve me te perparuara nderkombetare, kerkon mbeshtetjen e tij ne tre shtyllat kryesore qe e perbejne ate dhe qe jane:

- ❑ Sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të fortë financiar si një përgjegjësi kryesore e menaxherëve të çdo qendre shpenzuese publike, me një theks të veçantë në kërkesat minimale të kontrollit financiar.
- ❑ Nje shërbimi i pavarur i funksionit të auditit të brendshëm i bashkangjitur menaxhimit te larte të qendrës shpenzuese përkatëse, për të vlerësuar cilësinë dhe frytshmerine e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit financiar dhe për të bërë rekomandime për permiresimin e tyre.
- ❑ Shërbimi qendror i harmonizimit dhe metodologjise në Ministrinë e Financave,i cili ka si objektiv zhvillimin e një metodologjie të harmonizuar

dhe një cilësie të standartizuar të sistemit të kontrollit dhe menaxhimit financiar.

Për të përshtatur këto tre kërkesa, Leter Politikat për sistemin e kontrollit të brendshëm financiar publik synojnë:

- ✓ Të qartësojë përkufizimet mbi sistemin e kontrollit financiar të brendshëm publik dhe dallimin midis këtij sistemi dhe funksionit të auditimit të brendshëm.
- ✓ Të japin rekomandimet baze për projektimin e një sistemi funksional të Kontrollit brendshëm financiar publik në R.Sh., i aftë që të sigurojë përdorimin e burimeve publike në përshatje me ligjet dhe rregullat si dhe me dobi, kursim dhe frytëshmeri.
- ✓ Të konsolidojë një funksion efektiv të auditimit të brendshëm dhe të forcojë pavarësinë e tij nëpërmjet përcaktimeve ligjore dhe dokumentave të vecante të miratuar nga autoritetet qeveritare. Kjo duhet të reflektojë kushtet nën të cilat duhet të veprojnë auditët e brendshëm si dhe të përmirësojë procedurat për caktimin dhe shkarkimin e auditëve të brendshëm.
- ✓ Të krijojë dhe të forcojë funksionin e shërbimit qendror të inspektimit të buxhetit në MoF, si një instrument për të garantuar disiplinën buxhetore në të gjithë sektorin publik.
- ✓ Ngritja e një sistemi monitorimi dhe raportimi i përshatshëm, që të sigurojë një transparencë të plotë të përdorimit të burimeve publike. Ky sistem duhet të mbështesë qeverinë në procesin e vendimmarrjes dhe në vlerësimin e menaxhimit ekonomik, eficient dhe efektiv të shpenzimeve dhe të ardhurave.
- ✓ Krijimin e një njesie qendrore për harmonizimin e metodologjive të kontrollit brendshëm financiar publik në mënyrë të tillë që të sigurojë në mënyrë paraprake ekonomine dhe eficienten e përdorimit të burimeve publike.

Sipas çështjeve të përmendura më lart, implementimi i një sistemi efikas të KBFP kërkon një përshkrim të qëllimeve, objektivave dhe procedurave të detajuara për përbërësit e ndryshëm të këtij sistemi dhe një trajnim profesional afat gjatë të organizuar nga një institut publik me kurrikula specifike që i përshkruajnë auditimit të brendshëm dhe shërbimeve financiare në sektorin publik.

Vendosja dhe zbatimi i një sistemi të përmirësuar të KBFP në Shqipëri ka nevojë për bashkëveprimin e gjere të personave kyç në nivelet e caktuara të institucioneve të përfshira në sektorin publik. Menaxheret në qendrat shpenzuese të buxhetit dhe titullaret e tjere të subjekteve publike, duhet të jenë të ndërgjegjshëm dhe të kuptojnë që një sistem i kontrollit të brendshëm është thelbësor për ekonominë, funksionimin eficient dhe efektiv të një subjekti në lidhje me qëllimet e saj, veprimet dhe burimet. Ndërsa ai (menaxheri) është përgjegjës për organizimin e duhur dhe zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, rishikimin dhe mirëmbajtjen e tij. E rëndësishme në këtë proces është krijimi dhe konsolidimi i një rrjeti mekanizmesh të mirëvendosur, për shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencës midis auditëve të brendshëm dhe shërbimeve të tjera mbikqyrese dhe menaxhimit.

3.Mjedisi i sistemit te kontrollit brendshem financiar publik ne Shqiperi

Me sistem kuptohet teresia e veprimtarive dhe e masave, organizimeve e procedurave, te cilat jane te lidhura midis tyre dhe te projektuara ne menyre te atille qe te veprojne se bashku ose vec e vec, ne funksion te plotesimit te objektivave te subjektit. Duke ju referuar ketij perkufizimi rezulton se sistemi i KBFP ne Shqiperi ka mangesi dhe te meta te cilat nuk sigurojne perdorimin efektiv te burimeve publike dhe arritjen e objektivave duke optimizuar perdorimin e tyre.

3.1.Aktoret kryesore te mjedisit te kontrollit.

3.1.1Kuvendi i Shqiperise.

Kuvendi i Shqiperise miraton gjithë legjislacionin primar ne Republiken e Shqiperise. Ne strukturat e kuvendit eshte Komisioni Parlamentar i ekonomise dhe i finances i cili ka nje rol te vecante ne ngritjen dhe konsolidimin e sistemit e KBFP jo vetem me miratimin e ligjeve por edhe me rekomandimet per qeverine lidhur me permiresimin e menaxhimit financiar.

3.1.2.Keshilli i Ministrave.

Keshilli i Ministrave funksionon ne baze te nje ligji te vecante dhe ka pergjegjesine kryesore para Kuvendit te Shqiperise per formulimin dhe ekzekutimin e politikave financiare dhe ekonomike, menaxhimin e financave publike dhe zbatimin e buxhetit te shtetit.Megjithate ligji si dhe rregullorja baze e funksionimit te tij nuk percaktojne pergjegjesi te vecanta ne kuader te KBFP ne nivel funksional.Keshilli i Ministrave ka ne perberje te tij nje departament te kontrollit administrativ i cili kryen inspektime ne nivel qendror dhe lokal per procedurat e vendimarrjes dhe zbatimin e tyre.Gjithashtu ministri shtetit kryen funksione te monitorimit dhe te kordinimit te matricave te qeverise ne zbatim te politikave dhe vendimeve perkatese.

3.1.3.Kontrolli i Larte i Shtetit.

Auditi i jashtem ne sektorin publik perfaqesohet nga Kontrolli i Larte i Shtetit, veprimtaria e te cilit rregullohet me nje ligj te vecante.Misioni i ketij institucioni eshte; "te kontrolloje administrimin e prones shteterore dhe zbatimin e buxhetit te shtetit ne subjektet e percaktuara ne ligjin organik te KLSH duke bere transparencen maksimale te mundeshme te perdorimit te fondeve publike ne dobi te taksapaguesve". Ne funksion te ketij misioni ai deperton pa kufizim ne te gjitha subjektete publike per te vleresuar rregullshmerine e transaksioneve por nuk ka detyrime te percaktuara per ushtimin e auditimit ne kohe dhe per te mbuluar fusha te caktuara.Ai vlereson edhe veprimtarine e auditimit te brendshem ne teresi si sistem duke u kujdesur edhe per standartet.

KLSH ne perfundim te auditimeve nxjerr rekomandime per masa disiplinore dhe me karakter organizativ duke perfshire edhe ndryshimin e ligjeve dhe dispozitave. Rekomandimet e tij nuk jane te detyrueshme per t'u zbatuar nga subjektet publike por ne teresi vleresohen dhe merren ne konsiderate.

3.1.4.Ministria e Financave.

Eshte aktorja kryesore e sistemit te KBFP ne Shqiperi. Ligji per buxhetin e shtetit si dhe ligji per Auditimin e brendshem ne sektorin publik parashikojne rolin e vecante te ministrise se financave ne menaxhimin financiar dhe sistemin e kontrollit brendshem ne pergjithesi.Megjithate, dispozitat aktuale vecanerisht ne fushen e menaxhimit financiar nuk krijojne hapësira te plote per ushtrimin e funksioneve te saj. Roli i saj ne ligjin aktual te buxhetit reduktohet ne respektimin e kalsifikimit buxhetor dhe ne pergaditjen metodologjike ne fushen e hartimit te buxhetit shtetit. Ligji Per auditimin e brendshem percakton se Ministria e Financave eshte pergjegjese per ngritjen dhe zbatimin e sistemit te kontrollit brendshem ne sektorin publik por nuk percaktohen me tej mekanizmat,detyrimet dhe pergjegjesite per realizimin e ketij funksioni.

3.1.4.1.Drejtorite e buxheti dhe e Thesarit.

Drejtoria e Buxhetit ne Ministrine e Financave ka rolin per pergaditjen e buxhetit vjetor dhe afat mesem te shtetit i cili miratohet ne parlament me ligje te vecanta. Ajo pergadit rregullat dhe procedurat perkatese per hartimin e buxhetit por nuk ka akses te mjaftueshem ne zera te vecante te buxhetit te pergaditur nga ministrite e linjes si dhe ne ekzekutimin e tij. Mbikqyrja e buxhetit eshte e reduktuar dhe konsiston pothuajse ne respektimin e klasifikimit buxhetor.

Zbatimi i buxhetit organizohet dhe realizohet nepermjet sistemit te thesarit dhe degeve te tije rajonale me nje sherbim qendror ne Ministrine e Financave(Drejtoria e Thesarit). Ato evidentojne dhe autorizojne perfundimisht pagesat e buxhetit por nje kontroll i mirefillte ex-ante ne qendrat e shpenzimeve buxhetore nuk eshte akoma i strukturuar. Nje rol te tille pervec qendrave shpenzuese duhet t'a kete edhe thesari por roli i ketij te fundit eshte i reduktuar vetem ne anen formale dhe qe ka te beje me dokumentat justifikues dhe me respektimin e klasifikimit buxhetor dhe te ruajtjes se kufijve te fondeve buxhetore. Gjithashtu thesari paraqet edhe raporte periodike per situaten e shpenzimeve dhe te te ardhurave te buxhetit dhe kryen monitorimin e ekzekutimit te buxhetit.

3.1.4.2.Drejtoria e kontabilitetit.

Eshte e vendosur gjithashtu ne ministrine e financave dhe ka per mision zbatimin e nje metodologjie unike per sistemin e kontabilitetit dhe te raportimit financiar ne sektorin publik dhe privat.Ajo vepron ne baze te ligjit per kontabilitetin te vitit 1993 dhe dispozitave te tjera zbatuese. Ne muajin Prill te vitit 2004, Kuvendi i Shqiperise ka miratuar Ligjin e ri per kontabilitetin,i cili parashikohet te hyje ne fuqi ne vitin 2006, implementimi i te cilit kerkon pergaditjen e nje sere aktesh te tjera qe kane te bejne me standartet kombetare qe do te adoptohen etj.

3.1.4.3.Drejtoria e Pergjitheshme e Auditimit brendshem dhe njesite e auditimit brendshem

Ne vitin 2000 eshte riorganizuar funksioni i auditimit te brendshem ne te gjithe sektorin publik, riorganizim i cili koniston ne krijimin e strukturave te auditimit te brendshem ne te gjithe ministrite dhe institucionet qendrore dhe subjektete publike, me nje Drejtori te Pergjithshme ne ministrine e financave. Eshte hartuar edhe eshte miratuar nje ligj "Per Auditin e Brendshem ne Sektorin Publik". Jane bere hapa te rendesishme ne arritjen e pavaresise funksionale dhe

organizative te auditimit te brendshem. Keshtu jane krijuar strukturat ne te gjitha ministrite e linjes, veprimtaria e auditimit te brendshem eshte rigorozisht e ndare nga punet e tjera operative, strukturat e auditimit raportojne direkt tek niveli me i larte i menaxhimit; planet e punes se auditimit ,ekzaminimi , raportimi dhe opinionet e auditit jane te pavarura, etj.

Eshte krijuar njesia qendrore e metodologjise se auditimit e cila eshte ne nivelin e Drejtorise se Pergjitheshme te Auditimit. Kjo drejtori ka pergaditur nje sere aktesh me karakter metodologjik si, Manuali i auditimit, Karta e auditimit te brendshem dhe Kodi i etikes per auditet e brendshem, te cilat jane miratuar ne KM. Kjo drejtori eshte riorganizuar me tej ne vitin 2004 dhe eshte ndare funksioni metodologjik dhe mbikqyres te auditimit brendshem, nga funksioni i auditimit te subjekteve te vartesis se Ministrise Financave, duke krijuar nje njesi te re auditimi si ne te gjitha ministrite e linjes, qe raporton drejtperdrejt tek ministri i financave. Jane kryer nje sere aktivitetesh trainimi dhe te tjera jane projektuar dhe jane ne process, me mbeshtetjen e programit CARDS te cilat do te synojne rritjen e aftesis dhe te njohurive te auditeve te brendshem e cila do te finalizohet me certifikimin e tyre si audite publike.

Eshte ngritur dhe funksionon Komiteti i Auditimit Brendshem i cili shqyrton dhe vlereson veprimtarine e auditimit brendshem ne sektorin publik dhe i jep rekomandimet perkatese ministrit te financave. Nje raport vjetor se bashku me rekomandimet perkatese, pergaditet nga Drejtoria e Pergjitheshme e Auditimit i dhe i paraqitet Komitetit te Auditimit dhe Ministrit te Financave dhe ky i fundit ja paraqet ate Keshilit te Ministrave.

3.1.5. Ministrite e linjes.

Ne te gjitha ministrite e linjes ka njesi te sherbimeve financiare dhe buxhetore te cilat kane per mision pergaditjen e buxhetit te ministrise dhe ekzekutimin e tij. Ministrite e linjes ne bashkepunim me Ministrine e Financave pergadisnin dhe udhezime te perbashketa per zbatimin e buxhetit. Nuk ka linja te qendrueshme raportimi, midis ministrive te linjes dhe Drejtorise Buxhetit dhe te drejtorise se Thesarit ne Ministrine e Financave

3.1.6. Njesite e qeverisjes vendore.

Kontrolli i brendshem ne njesite e qeverisjes vendore rregullohet me ligjin organik te buxhetit si dhe me ligjin per buxhetin lokal. Ligji per buxhetin lokal eshte i vitit 1993 dhe i amenduar ne vitin 1998 nderkohe qe procesi i organizimit dhe funksionimit te pushtetit vendor ka pesuar ndryshime te ndjeshme drejt decentralizimit. Ne keto rrethana ndjehet i nevojshem nje ligj per Financat e Pushtetit Vendor i cili duhet te percjelle procesin e decentralizimit dhe te rregulloje buxhetin lokal si dhe administrimin e burimeve te tjera publike si ndermarrjet e institucionet buxhetore ne vartesi te njesive te qeverisjes vendore. Ky ligj kerkohet te jete ne koherence me standartet e KBFP dhe ligje te tjera organike.

3.1.7. Subjektet publike te shenderruara ne sh.a.

Ekzistojne nje numur i konsiderueshem ndermarrjesh publike te shenderruara ne sh.a si dhe institucione te tjera publike si institute te ndryshme te cilat zhvillojne biznes ne perputhje me statusin e tyre. Baza ligjore e ushtrimit te veprimtarise se tyre eshte ligji "Per shoqerite tregtare" dhe dispozita te tjera te

cilat nuk bejne ndonje rregullim te vecante ne drejtim menaxhimit te financiar te tyre. Ne kushtet e subjekteve publike , qe konsiderohen si sh.a. ose forma te tjera ku pothuajse kapitalet e tyre jane njeqind perqind shteterore ose me dominance shteterore, eshte e domosdoshme qe te behen rregullime baze te veprimtarise se ketyre ne drejtim te menaxhimit financiar. Pervoja e auditimeve ka vertetuar se ne keto ndermarrje jane vertetuar shkelje dhe abuzime te rendesishme ne dem te interesave publike per shkak se kontrollet e brendshme kane qene inekzistente ose se ato jane ndertuar ne kundërshtim me standartet. Te tilla shkelje jane vertetuar ne Albtelecom ne Insig etj. Ligji Nr.6942 date 25.12.1984 "Per qarkullimin dhe dokumentimin e vlerave materiale e monetare " megjithese eshte ne fuqi nuk mund t'a kryeje funksionin e nje kontrolli efektiv per shkaqe qe do t'i permendim ne vijim. Ne pergjithesi ne keto subjekte jane krijuar struktura te auditimit te brendshem por pavaresia e tyre funksionale dhe organizative eshte e dobet. Lidhjet e ketyre strukturave jane drejperdrejt me ekzekutivin dhe jo me bordin nderkohe qe po behen perpjekje per t'i vendosur ne pozicione raportimi kundrejt bordit.

3.1.8. Institucionet publike te pavarura.

E njejta suate si me siper eshte edhe ne institucionet publike te pavarura, vecse me ndryshimin se problematika e shkeljeve dhe demtimit te interesave publike eshte me intensive. Duke qene se Qeveria nuk ka ndonje mandat per auditimin e tyre , fale edhe kufizimeve qe ka pavaresia e auditimit te brendshem ne keto institucione dhe ne disa raste edhe e mungeses se ketij funksioni, nga KLSH jane vertetuar nje seri shkeljesh dhe parregullsish ne dem te interesave te shtetit. Rregullimet e kontrollit te brendshem ne keto institucione jane shume te kufizuara dhe evazive qe mundesojne dhe krijojne hapesira per abuzime e parregullsi. Ne keto rrethana eshte e domosdoshme qe te behen rregullime te kontrollit brendshem ne nivel funksional ne menyre te perqendruar duke krijuar hapesira institucioneve te pavarura per rregullime ne nivel operacional.

3.2. Kuadri ligjor.

3.2.1. Kuadri ligjor i trasheguar.

Akoma ne R.SH. eshte ne fuqi ligji Nr.6942 date 25.12.1984 "Per administrimin, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare" i cili perben bazen kryesore aktuale te kontrollit brendshem. Ky ligj nuk rezulton te jete i zbatueshem per arsyet e meposhtme:

- a- Ligji eshte i ndertuar per nje sistem teresisht te centralizuar te ekonomise.
- b- Ai nuk eshte i harmonizuar me Kushtetuten e RSH dhe paraqet disa kontradiksione.
- c- Rregullimet e ketij ligji jane pjesore dhe nuk perfshijne gjithe sektorin publik.
- d- Nuk eshte ne pajtim me ligjet e tjera organike si ate te buxhetit, te sherbimit civil te kontabilitetit etj.

- e- Paraqet kundërshtime me standartet ndërkombëtare për kontrollin e brendshëm dhe nuk krijon hapësira subjekteve publike për rregullime të vazhdueshme e të metejshme duke përguar kështu menaxhimin efikas të burimeve publike.

Ne zbatim të këtij ligji është një vendim i KM Nr.70 i vitit 1984 i cili përcakton disa rregulla e procedura për administrimin e burimeve publike. Po kështu në ministri dhe institucione qendrore vecanërisht në Ministrinë e Rendit Publik dhe atë të Mbrojtjes vazhdojnë të jenë efektive urdhera dhe udhëzime në frymën e këtyre dispozitave.

Neni 118 i Kushtetutës së R.Sh. i ndalon subjektet publike të nxjerrin dispozita, urdhera udhëzime etj. kur ato nuk janë të autorizuar në mënyrë të qartë nga një ligj. Në këto rrethana ka një gjendje ngerci në zhvillimin e kontroleve të brendshme vecanërisht në nivel qendror. Sa më sipër është imediate dhe imponohet nevojë e hartimit të një ligji "Për kontrollin e Brendshëm Financiar Publik" i cili të përcaktojë përgjegjësitë e strukturave publike dhe të hapë rrugë subjekteve [publike dhe nivele perkatese të menaxhimit për zhvillimin e metejshëm dhe të vazhdueshëm të sistemit.

3.2.2. Kuadri ligjor aktual.

Ekzistojnë një sërë ligjesh rregullash procedurash dhe dispozitash të cilat janë elemente të kontrollit brendshëm financiar publik. Kështu ekziston ligji organik i buxhetit "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit" i miratuar në vitin 1998. Procesi i hartimit dhe zbatimit të buxhetit është në një proces rishikimi teresor dhe ka filluar të draftohet një ligj i ri organik. Ligji parashikon rregullat dhe procedurat për hartimin e zbatimin e buxhetit të shtetit në teresi dhe shoqërohet çdo vit me udhëzime të vecanta. Ky ligj parashikon edhe rregullat e kontabilizimit buxhetor sipas klasifikimit të miratuar duke sanksionuar atë që quhet disiplinë buxhetore por nuk shkon më tej dhe nuk e ka për mision përcaktimin e rregullave dhe të disiplinës financiare në përdorimin e këtyre fondeve.

Ligji "Për kontabilitetin" i cili është miratuar në vitin 1993 u ndryshua me një ligj të ri në Prill të vitit 2004. Ky ligj ka përcaktuar standartet kryesore të kontabilitetit dhe një sërë aktesh të tjera kërkohej të plotësojnë kuadrin e këtij ligji dhe të kontabilitetit në teresi.

Ligji për "Statusin e Nepunësit Civil" i cili është miratuar në vitin 1999 është një ligj i cili përfshin disa aspekte të administrimit të burimeve njerezore dhe është në një proces rishikimi gjithashtu. Ky ligj vetëm sa cakton disa rregulla për rekrutimin e punonjësve të shërbimit civil por nuk e shtrin aktivitetin e tij në analizën dhe përdorimin e këtyre burimeve në nivel funksional si dhe nuk përcakton përgjegjësitë e strukturave për zhvillimin e burimeve njerezore. Nga ana tjetër ky ligj rregullon veprimtarinë e burimeve njerezore jo në të gjithë sistemin publik por vetëm në një pjesë të vogël të tij. Edhe në aktet e tjera nenligjore që e shoqërojnë këtë ligj nuk ka rregullime të vecanta për burimet njerezore të sektorit të menaxhimit financiar dhe të auditimit të brendshëm.

Ligji për prokurimin publik, aktet nenligjore që e shoqërojnë dhe manuali perkates i prokurimit publik përbejnë një kuader të plotë në këtë fushë megjithë nevojën që ato kanë për përpunimin dhe përsosjen e tyre të vazhdueshme, për

shkak se ne procesin e implementimit te tyre jane konstatuar shkelje dhe parregullsia te shumta.

4.Disa konkluzione,dobesi dhe boshlleqe.

Referuar pikes "3" te ketij dokumenti "Mjedisi i sistemit te KBFP ne Shqiperi" rezulton se ka shume mangesi,boshlleqe dhe mungese organizimesh e strukturash per funksionimin e KBFP.

Ministria e Financave ka hartuar nje inventar te kontrolleve te brendshme ekzistuese si dhe te boshlleqeve ne nivel ministerial i cili duhet te mbahet parasysh ne projektimin e kontrolleve dhe ne planin e veprimit qe do te hartohet per implementimin e sistemit te KBFP ne Shqiperi.Per kete arsye nuk po i permendim ato radhazi por ne menyre te permbledhur si me poshte:

- Ka nje vakum per rregullimin e veprimtarive te sistemit financiar ne teresi,si ato qe kane te bejne me thesarin, borxhin e brendshem dhe te jashtem, financimet e huaja etj.
- Nuk ka parime dhe rregulla baze te unifikuara, mbi te cilat ministrit dhe institucionet qendrore duhet te hartojne rregullat dhe te percaktojne procedura per zbatimin e programeve dhe arritjen e objektivave
- Subjektet publike qe jane ne process privatizimi jane te pambuluar me kontrolle te brendshme ose ato ekzistente nuk funksionojne ne sistem me pjesen tjeter te sektorit publik.
- Kontrollat e brendshme aktuale (ligjet dhe dispozitat) pergjithesisht nuk jane te integruara ne sistem dhe me komponentet e tjere te KBFP
- Ka dispozita te vjetra qe e kane humbur perdorimin per shkak te papajtueshmerise me ligjet dhe Kushtetuten
- Ka mungese rregullimesh ligjore dhe proceduriale per administrimin e vlerave materiale e monetare,dokumentimin e punes dhe te pagave etj.
- Nga strukturat administrative te ministrive te linjes dhe nivelet e ndryshme te menaxhimit, nuk njihen ne shkallen e duhur standartet nderkombetare per kontrollin e brendshem.
- Aktet e nxjerra per kontrollat e brendshme, mbeshtetur ne Kushtetuten e RSH, ne Ligjet, apo VKM, sipas niveleve, nuk mbajne parasysh kerketat e standarteve te kontrollit brendshem, per vete faktin se keto standarte nuk jane njohur nga hartuesit e tyre.
- Nuk ka ndarje te qarta e te sakta detyrave role e pergjegjesive,nuk jane respektuar standarte te tilla si siguria e arsyeshme, qendrimi mbeshtetes, kompetenca e personelit,objektivat, teknikat dhe monitorimi i kontrolleve etj .Menaxheret dhe politikeberesit e kontrolleve te brendshme nuk i njohin standarte te tilla si dokumentimi,rregjistrimi i transaksioneve dhe ngjarjeve, ekzekutimi i tyre, ndarja e detyrave, mbikqyrja dhe verifikimi i aseteve, etj.
- Nuk ka nje ligj organik qe te autorizoj zhvillimet e kontrollit brendshem ne subjektet publike dhe nxjerrjen e akteve perkatese.

5.Rekomandime te organizmave nderkombetare per sistemin e KBFP.

Qeverija e R.SH. ne programin e saj per periudhen 2002-2005 ka si prioritet reformimin e financave publike dhe ne kete kuader nje vend te vecante ze ngritja e nje kuadri te plote ligjor e procedural per kontrollin e brendshem ne sektorin publik.

Ne shume raporte te organizmave nderkombetare eshte trajtuar ceshtja e organizimit dhe funksionimit te kontrollit brendshem financiar publik. Aty evidentohet nevoja e strukturimit te ketij sistemi. Disa nga mosarritjet ne fushen e financave publike dhe te menaxhimit te shpenzimeve i adresohen dobese se kontrollit brendshem financiar publik. Ne takimin e 8 te konsultativ te Task Force Shqiperi BE me 23 Prill 2004 ne Tirane u theksua nevoja e hartimit te nje dokumenti perfundimtar per zhvillimin e KBFP ne Shqiperi. Edhe Banka Boterore ne raportet e meparshme per vleresimin e pergjegjeshmerise financiare ka vleresuar dhe theksuar nevojën per forcimin e kuadrit ligjor per kontrollin e brendshem publik.

6.Drejtime te forcimit te KBFP ne Shqiperi.

6.1.Forcimi i pergjegjesise menaxheriale.

Me pergjegjesi menaxheriale do te kuptojme pergjegjesine e menaxhereve per cilesine dhe kohezgjatjen e realizimit te programeve, rritjen e efikasitetit kontrollimin e koston dhe menaxhimin e zbutjen e tendencave te kunderta qe rrjedhin nga zbatimi i programeve me dobi kursim dhe frytshmeri. Pergjegjesia menaxheriale perfshin pergjegjesine e menaxhereve te te gjitha niveleve per disenjimin e kontrolleve te brendshme, mirembajtjen dhe rishikimin e tij.

Pergjegjsia menaxheriale nenkupton organizimin,parimet dhe procedurat e perdorura nga menaxhimi per te krijuar siguri te arsyeshme se:

- ☐ Programet i permbushin qellimet e veta te parashikuara.
- ☐ Burimet shfrytezohen ne pajtim me objektivat e subjektit
- ☐ Programet dhe burimet jane te mbrojtura nga keq perdorimet,mashtrimet dhe keq menaxhimet.
- ☐ Veprimtaria e subjektit zhvillohet ne pajtim me ligjet dhe rregulloret.
- ☐ Informacion financiar i besueshem, eshte perftuar, eshte mirembajtur dhe perdorur drejt ne procesin e vendimarrjes.

Kuadri i KBFP qe do te ristrukturohet sipas ketij dokumenti, eshte e nevojshme te theksoje me tej pergjegjesite e drejtimit per:

- ☐ Vendosjen e nje kuadri te plote te kontrollit te brendshem ne subjektin
- ☐ Vleresimin e rrezikut te kontrollit te brendshem
- ☐ Permiresimin e vazhdueshem te sistemit te kontrollit brendshem, mirembajtjen dhe rishikimin e vazhdueshem te tij.
- ☐ Ngritjen e burimeve te mjaftueshme te auditimit sigurimin e pavaresise se tyre dhe zbatimin e rekomandimeve te auditimit.

6.1.1.Zhvillimi i gjurmes se auditit.

- ❑ Menaxhimi i nivelit te larte per te realizuar pergjegjesine menaxheriale duhet te disenjoje dhe implemetoje "gjurmet e auditit" ne menyre qe t'i krijoj vehtes lehtesirat e duhura ne marrjen e informacionit per arritjen e objektivave dhe auditeve kushte te pershtateshme per vleresimin e veprimtarise se subjektit dhe dhenien e rekomandimeve. Nje gjurme auditit duhet te jete kurdohere e hartuar dhe e formuluar sipas standarteve perkatese dhe me simbole e skema te kuptueshme dhe te spjeguar e te kuptuara qarte pa ekuivoke.

6.1.2.Permiresimi i procedurave te buxhetimit.

Ligji i ri organik i buxhetit te shtetit i cili eshte duke u pergaditur synon permiresimin rrenjesor te procedurave te buxhetimit ne perputhje me pervojat me te perparuara.Ligji po hartohet me asistencen e huaj dhe synon te percaktoje parimet, te rregulloje procedurat dhe pergjegjesite ne te gjithe procesin e hartimit dhe te zbatimit te buxhetit te shtetit ne R.Sh. dhe me konkretisht:

- ❑ hartimin, pergatitjen, propozimin dhe miratimin e Buxhetit te Shtetit, buxheteve te komunave, bashkive dhe qarqeve dhe te planeve financiare te Fondeve Speciale.
- ❑ Ekzekutimin ,zbatimin e Buxhetit te Shtetit dhe te buxheteve vendore dhe te planeve financiare te fondeve speciale.
- ❑ Inspektimin, monitorimin, kontabilitetin, raportimin dhe kontrollin e zbatimit te Buxhetit te Shtetit dhe buxheteve vendore dhe te planeve financiare te fondeve speciale.
- ❑ Huamarrjen nga qeverisja qendrore, njesite e qeverisjes vendore dhe njesite e fondeve speciale.
- ❑ Garancite dhe borxhet e tjera te qeverisjes qendrore, njesive te qeverisjes vendore dhe njesive te Fondeve Speciale.
- ❑ Huamarrjen dhe garancite e ndermarrjeve publike dhe njesive te tjera institucionale ne te cilat, njesia apo njesite e qeverisjes qendrore ose vendore, ka apo kane nje influence vendimtare ne drejtimin e tyre, ose sigurojne nje perqindje domethenese te financimit te tyre.

Pervec sa me siper eshte e domosdoshme qe procesi i hartimit dhe i zbatimit te buxhetit te shtetit te siguroje sa te jete e mundur paraprakisht performancen (efektivitetin dhe eficensen) e shpenzimeve, qe ne procesin e planifikimit duke vendosur procedura ne kete drejtim vecanerisht ne fushen e investimeve publike.

Megjithese projekt ligji parashikon nje lloji inspektimi te buxhetit nga axhentet kontabel ky rol kerkohet te forcohet edhe me tej nepermjet funksionit qendror ne Ministrine e Financave duke depertuar deri ne vendimarrjet e qendrave shpenzuese.

Nga ana tjeter Ligji i ri i buxhetit, qe te mund te implementohet me sukses kerkon trainimin e punonjesve te sherbimeve te buxhetit dhe ato financiare si dhe hartimin e rregullave e procedurave te shkruara ne nivelin e nje manuali.

6.1.3.Forcimi dhe permiresimi i rolit te thesarit, kryekontabilistit dhe kontrollit ex-ante

Aktualisht thesari ka nje rol te zbehte dhe eshte i fokusuar ne anen formale te respektimit te disiplines buxhetore.Zhvillimet qe jane duke u projektuar ne kete

sektor duhet te synojne forcimin e rolit te ketij sistemi per te siguruar perdorimin efektiv te fondeve publike duke i dhene me shume hapesire per te ndikuar vendimarrjet e qendrave shpenzuese.

Kontrollet e brendshem aktuale nuk percaktojne ndonje rol te vecante te kyekontabilistit ne vendimarrjet dhe menaxhimin e burimeve publike ne teresi. Sistemi i nenshkrimit te dyfishte i trasheguar si nje mjet kontrolli ex-ante nuk eshte ne nivelin e duhur dhe nuk ka rregullime te plota, per shkak se dispozitat rregullatore mbi te cilat eshte mbeshtetur jane shume te vjeteruara dhe kerkohet rinovimi i ketij funksioni ne kuadrin e mjedisit aktual.

Eshte e nevojshme qe pa cenuar rolin e menaxhimit te larte dhe pergjegjesite e tij per sistemin e kontrollit brendshem te forcohet roli i kryekontabilistit ne vendimarrje si dhe ne autorizimin e transaksioneve si dhe te veprimeve qe kane te bejne me burimet publike ne teresi. Nje skeme paraprake e pergjegjesive te tij do te parashikonte dhenien e opinionave me shkrim dhe paraqitjen e tyre menaxhimit te larte per ceshtje per te cilat ai ka mendime te ndryshme, si dhe marrjen e pergjegjesine se menaxherit te larte ne rast te mosmarrjes parasysh te opinionave te kryekontabilistit. Mund te orjentohej dhe te klasifikohet autoriteti deri edhe ne refuzimin e pagesave ose te nenshkrimit per shuma mbi nje nivel te caktuar qe paraqesin rrezik per interesat publike.

Nderkohe jane te domosdoshme hartimi i procedurave per ndarjen e detyrave dhe shkallezimin e delegimin e autoritetit, manuale dhe procedura operacionale pune per cdo post etj., si dhe vendosjen e procedurave te mirefillta dhe te njehsuara ne procedurat e kontrollit ex-ante, vecanerisht per vendimarrjet ne funksion te perdorimit te burimeve publike.

6.1.4. Zhvillimi dhe implementimi i metodologjive te vleresimit rrezikut dhe menaxhimit te tij.

Ne vendin tone ne te gjithe sistemin e kontrollit brendshem financiar publik dhe ne ate te auditimit brendshem dhe te jashtem nuk jane zhvilluara metodologjite e vleresimit te riskut. Auditimi i brendshem ka adoptuar ne manualin e tij disa metoda per vleresimin e riskut te auditit dhe elemente te vleresimit te riskut te kontrollit brendshem por ato nuk jane te majftueshme per sistemin e KBFP. Vleresimi i riskut eshte njepoces dhe pergjegjesi e menaxhimit dhe duhet te organizohet e kryhet prej tij. Ne kete kuptim eshte e domosdoshme zhvillimi i nje kuadri metodologjik per vleresimin e riskut ne ndertimin e nje sistemi te KBFP i cili duhet te perfshije:

- ☐ Kuptimin dhe permbajtjen e vleresimit te riskut
- ☐ Identifikimin e riskut
- ☐ Analizen, vleresimin dhe matjen e riskut
- ☐ Menaxhimin e riskut.

Është e rëndësishme që menaxhimi i subjektit publik të jetë i ndërgjegjshëm dhe të njohe:

- ✓ Riskun e pranishëm në zonën e aktivitetit të tij;
- ✓ Pasojat e mundshme dhe efektin e përgjithshëm të riskut;
- ✓ Metodot efektive për vlerësimin dhe identifikimin e risqeve të mundshme

- ✓ Proçedurat e kontrollit të brendshëm për parandalimin dhe menaxhimin e riskut.
- ✓ Veprimet alternative të marra në rast të vertetimit të riskut.

Gjithashtu duhet të jete e qarte se, është përgjegjesi e menaxhimit të vleresojë dhe të ballancojë raportet midis kostos dhe përfitimit për kontrollet e brendshme të ndertuara në procesin e menaxhimit të riskut.

6.2. Monitorimi dhe Inspektimi financiar

Ministritë e linjes kanë ngritur njësi të vecanta ose ad-hoc monitorimi veacnerisht për problemet që lidhen me strategjinë kombetare të zhvillimit. Ministria e financave kryen veprimtari monitoruese të ecurisë së të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit nepermjet degeve të thesarit në rrethet. Por këto veprimtari nuk janë të organizuara mirë dhe nuk përfshijnë gjithë rrethin e menaxhimit financiar. Funksionimi i tyre akoma nuk zhvillohet mbi bazën e procedurave të shkruara dhe përsëkrime të sakta të objektivave të tyre.

Inspektimi financiar është inekzistent dhe funksione të caktuara të tij deri kohët e fundit janë kryer nga njësitë e auditimit brendshëm por kjo nuk është në përputhje me misionin e tyre.

Në këto rrethana për të ndërtuar një shërbim të fortë qendror të harmonizuar dhe për të siguruar një kontroll të plotë në sistemin buxhetor, është e nevojshme të forcohen përgjegjësitë e Ministrisë së Financave në fushën e monitorimit dhe inspektimit financiar. Një funksion i inspektimit financiar brenda ministrisë së financave në përberje të Drejtorisë së buxhetit ose jashtë saj do të ishte e nevojshme për këtë qëllim duke qenë përgjegjës për:

- Respektimin e metodologjisë dhe standarteve në lidhje me menaxhimin dhe kontrollin financiar në sektorin publik;
- Të sigurojë këshilla teknike për nivelet e menaxhimit në qendrat e shpenzimeve.
- Të inspektojë në të gjitha qendrat e shpenzimeve buxhetore lidhur me zbatimin e procedurave të buxhetit dhe të thesarit në hartimin dhe ekzekutimin e buxhetit dhe të japë rekomandimet e duhura.
- Të vlerësojë nëse rekomandimet e tij ndiqen dhe nëse është e nevojshme, koregjimet të bëhen në një kohë sa më të pershtatshme.
- Të organizojë bashkëpunim të vazhdueshëm me drejtuesit e njësive të shërbimit të auditimit brendshëm dhe me njësine qendrore të harmonizimit të metodologjisë së kontrollit brendshëm.

Nga ana tjetër struktura e kontrollit administrativ duhet të ngrihet në të gjitha rajonet (prefekturat). Këshilli i Ministrave ka një departament të kontrollit administrativ i cili kryen funksionet e inspektimit për zbatimin e vendimeve të qeverisë dhe urdherave të kryeministrit. Ndonjëherë këto funksione kapërcehen dhe depertojnë edhe në vlerësimin e performancës së strukturave administrative në plotësimin e objektivave dhe matricave të caktuara nga Këshilli i Ministrave.

Duke qenë se në kemi të organizuar prefekturat si një strukturë ndërmjetesë midis Qeverisë dhe njësive rajonale e vendore, roli i tyre nuk mund të jete efikas pa zhvilluar dhe organizuar në nivel të mirë edhe kontrollin administrativ në të

gjithë komponentet e tije përfshirë edhe ngritjen e funksioneve të kontrollit administrativ në prekturë.

6.3.Permiresimi dhe zhvillimi i procedurave të prokurimit.

Kuadri ligjor i prokurimit publik në pamje të parë duket i plotësuar. Për këtë ka një ligj baze organik të amenduar disa herë disa vendime të keshilit të Ministrave dhe udhëzime të vecanta të KM, manuale të Axsensise së prokurimit publik dhe dokumenta standarte të prokurimit. Megjithatë niveli i shkëlqejve të ligjit si dhe i zbatimit formal të tij janë shumë prezente në këtë fushë, gjë e cila raportohet si nga KLSH ashtu edhe nga strukturat e auditimit të brendshëm. Kjo imponon rishikimin e terësor të këtyre dispozitave me qëllim shmangien e hapesirave ligjore për abuzime. Vecanerisht duhen forcuar kriteret për përcaktimin e fondit limit, shmangien e formave të prokurimit që kufizojnë konkurrencën e lirë (ftesa për oferte, tenderi i kufizuar), rishikimin e rregullave të metejshme për vlerësimin e ofertave, hartimin e kriterëve për përcaktimin e specifikimeve teknike, krijimin e hapesirave për nxjerrjen e rregullave në nivel operacional nga subjektet publike që prokurojnë fonde, shmangien e konfliktit të interesave etj.

6.4.Zhvillimi i kuadrit të plotë për burimet njerezore hartimi kriterëve dhe kurrikulave për pozicionet e punës në sistemin e financave publike.

Rekrutimi i punonjësve të shërbimeve financiare dhe të buxhetit nuk bëhet mbi kriterë të unifikuar. Përkrahimet e vendit të punës gjithashtu nuk janë të hartuara mbi bazën e disa kriterëve baze dhe unike për të gjitha këto shërbime. Nderkohe trainimi i këtyre nëpunësve është në nivele minimale dhe jo i mirëorganizuar. Një sistem i fortë i KBFP kërkon zhvillimin e burimeve njerezore i cili është komponenti baze i mjedisit të kontrollit. Ky zhvillim kërkohej të jete i organizuar dhe i rregulluar me norma të vecanta. Madje pa rregulluar këto elemente asnjë kontroll i brendshëm i projektuar nuk do të kishte sukses dhe do të rrezikohesh të deshtonte. Për këtë arsye sistemi në fjalë duhet të përcaktohet;

- Kriteret unike baze të rekrutimit në të gjitha nivelet e shërbimeve financiare.
- Norma kualifikimi dhe programe trainimi bazuar në kurrikula profesionale bashkohore.
- Kërkesat unike baze të përkrahimeve të vendit të punës.
- Një mbrojtje të vecantë për punonjësit e shërbimeve financiare

Mbi bazën e këtyre kërkesave, subjektet publike duhet të përcaktojnë kriterë dhe kërkesa specifike për burimet njerezore në përputhje me vecoritë e subjektit dhe të posteve të punës.

Njësia qendrore e harmonizimit të metodologjive së kontrollit brendshëm duhet të marrë përsipër edhe funksionet e mesipërme që kanë të bëjnë me unifikimin dhe përcaktimin e kërkesave baze për kuadrin e burimeve njerezore.

6.5.Permiresimi i shërbimit të kontabilitetit.

Sic e përmendëm edhe më sipër Kuvendi i Shqipërisë në muajin Prill ka miratuar ligjin e ri "Për kontabilitetin". Ky ligj përcakton detyrimet me të përgjithëshme të organizimit mbajtjes së kontabilitetit dhe publikimit të pasqyrave financiare. Por që ky ligj të jete efektiv kërkon ndërmarrjen e një sere hapash të vecantë në nxjerrjen e akteve të tjera si standartet kombëtare të kontabilitetit,

manualin e kontabilitetit etj. Procesi i adoptimit te ligjit te ri paraqet ne vetevehte nje rrezik per sistemin e kontrollit brendshem i cili duhet vleresuar nga nivelet e menaxhimit dhe strukturat perkatese me qellim qe te shmangen parregullsise ne pasqyrimin e veprimtarive te subjekteve. Ky rrezik konsiston ne ndryshimin e sistemit, ne vonesat ne hartimin e standarteve kombetare, vonesa ne implementim dhe veshtiresite ne harmonizimin me komponente te tjere te kontrollit brendshem.

Gjendja e aktuale e sherbimit te kontabilitetit ne subjektet publike nuk siguron nje informacion te plote dhe vecanerisht ne kohe te ngjarjeve ekonomike. Kjo per shkak se ne pjesen dermuese ky sherbim eshte manual.

Nisur nga gjendja jo e kenaqshme e sherbimit te kontabilitetit ne njesite publike kerkohet te ndermerren hapa lidhur me informatizimin e sherbimit dhe pergaditjen e softeve te vecanta sipas vecorive te sherbimit.

6.6. Permirësimi i funksionit te auditimit te brendshem.

Auditimi i brendshem ka njohur zhvillime te rendesishme te cilat i pershkruam me lart. Por keto zhvillime jane akoma ne nivelin e hartimit te dokumentave baze te auditimit dhe implementimi i tyre kerkon ndermarrjen e disa veprime te metjeshme si;

6.6.1 Me miratimin e manualit te auditimit , njesite e auditimit te brendshem ne ministrite e linjes duhet te persosin me tej normat e auditimit ne perputhje me sektoret e vecante publike ,duke marre parasysht vecorite e tyre.

6.6.2. Konsolidimi i funksionit te Drejtorise Pergjitheshme te Auditimit te Brendshem duke i dhene asaj plotesisht fizionomine e Njesise Qendrore te Harmonizimit, orjentuar qartesisht nga funksioni metodologjik dhe i monitorimit te auditimit te brendshem ne sektorin publik. .

6.6.3. Pergaditja e kurrikulave dhe e programeve te trainimit ne fusha te vecanta te cilat do te finalizohen me certifikimin e auditeve te brendshem si dhe pergaditja e kualifikimi me i thelle i niveleve te tjera te auditeve vecanerisht te moshave te reja dhe i menaxhereve te auditit, duhet te jete pjese e programit per forcimin e funksionit te auditimit.

6.6.4. Situata e mbivendosjes se funksioneve ne auditimin e qeverisjes lokale si dhe midis Ministrive te linjes dhe subjektev vartese, duhet te marre fund duke inkurajuar dhe forcuar funksionin e auditimit te brendshem te njesive te subjekteve perkatese ne respekt te kartes se autonomise vendore.

6.6.6. Forcimi i bashkepunimit midis auditimit te brendshem dhe KLSH duhet t'i krijojte hapesira te plota sherbimit te auditimit brendshem ne funksion te menaxhimit te burimeve publike dhe te shmange kryerjen e auditimit nga KLSH, si auditim i brendshem. Vleresimi i performances se auditimit brendshem dhe inkurajimi i pavaresise funksionale te auditit, vleresimi i veprimtarise statutore dhe i kufizimeve te mundeshme te pavaresise, duhet te jene ne fokus te punes se KLSH ne raport me auditimin e brendshem.

6.6.7. Pavaresia funksionale e auditimit te brendshem akoma nuk eshte siguruar plotesisht. Keshtu ndonese jane bere hapa ne drejtim te ndarjes se strukturave dhe vecimit te veprimtarise auditimit nga veprimtarite e tjera te subjektit, raportimit te niveli me i larte i menaxhimit, formulimi i raporteve dhe i rekomandimeve etj. hapa te tjere duhen ndermarre vecanerisht ne:

- Emerimin,shkarkimin,transferimin ose masa te tjera disiplinore te nje niveli te caktuar duhet te konfirmohen nga Komiteti i Auditimit .
- Permiresimin e motivimit dhe te shperblimit ne pune si dhe garantimin e karrieres ne sektorin publik pas plotesimit te kushteve te vecanta.
- Clirimin e auditeve nga detyrimi per te propozuar masa disiplinore te cilat demtojne pavaresine e tyre.

Sa me siper kerkon nderhyrje ne legjislacionin ekzistues.

6.6.8.Nje process certifikimi i auditeve publike eshte projektuar ne dispozita te vecanta por kerkohen hapa dhe angazhime te metejeshme per te realizuar kete ne perputhje me pervojat me te mira te vendeve te BE dhe per te siguruar vazhdimesine e ketij procesi.Ne kete kuader eshte parashikuar certifikimi i auditeve ne dy faza;Faza e pare perfshin certifikimin e perkohshem te auditeve e cila eshte realizuar dhe faza e dyte certifikimin perfundimtar. Programi per certifikimin e auditeve duhet te siguroje ngritjen ne nje nivel cilesor te auditimit dhe nje perputhje te kesaj veprimtarie me standartet nderkombetare.

6.7.Permiresimi i procedurave per te ardhurat dytesore.

Ne pergjithesi te gjitha institucionet publike grumbullojne te ardhura dytesore qe vijne nga zhvillimi i veprimtarise se tyre ne formen e disa tarfiave sherbimi. Ka nje vendim te Keshillit te Ministrave per disiplinimin e ketyre te ardhurave por praktikisht kjo veprimtari nuk eshte plotesisht nen kontroll.Shpesh here kjo ka qene subjekt i konstatimeve per parregullsiti, nga auditimi i brendshem dhe KLSH si dhe media. Ka kufizime te insitucionit ne grumbullimin e ketyre te ardhurave,raporte jo te pershtateshme me buxhetin e shtetit te cilat frenojne rritjen e tyre,nderkohe qe ka mungese procedurash funksionale per dokumentimin e kesaj veprimtarie e cila shpesh here sic e permendem, ka qene objekt parregullsish

Per rrjedhoje kerkohet te zhvillohen politika te qarta per grumbullimin e ketyre te ardhurave, me synimin per te decentralizuar kete process dhe per te lehtesuar buxhetin e shtetit dhe krahas kesaj vendosjen e procedurave rigoroze per administrim ne perputhje me politikat e caktuara duke bere kujdes qe ky proces te mos shendrohet ne nje proces taksimi.

7.Zhvillime te reja te KBFP

7.1.Zhvillimi i elementeve te KBFP per detyrimet,pergjegjesine materiale dhe financiare.

Kontrollet e brendeshme aktuale nuk sigurojne ne menyre te plote pergjegjesine materiale dhe financiare te te punesuarve ne subjektet publike si dhe rikuperimin e pagesave te padrejta ose shumave te marra me teper.Disa rregullime jane ne Kodin Civil te RSH por ato nuk jane te plota dhe nuk percaktojne procedurat si rregullat e vleresimit si dhe interesat e tjera shtese.Nga ana tjeter eshte e domosdoshme te hartohen procedura lidhur me pergjegjesine e menaxhereve per vendimarrjet e gabuara qe shkaktojne deme subjektit publik duke u orjentuar nga rregullimet e sektorit privat

7.2.Zhvillimi i procedurave administrative, per rastet e mashtrimeve shperdorimeve dhe veprave penale ne dem te fondeve publike.

Jane bere disa perpjekje ne manualin e procedurave te auditimit per te perfshire procedurat administrative ne investigimin e akteve kriminale qe zbulohen gjate auditimit por ato nuk jane te mjaftueshme dhe nuk rregullojne gjithë kuadrin perkates te KBFP. Kodi i Procedures Penale parashikon detyrimin e nepunesve publike per te referuar ne prokurori veprat penale te zbuluara gjate veprimtrise se tyre por nuk cakton procedura perkatese. KBFP duhet te percaktojë procedura administrative dhe pergjegjesite e menaxhimit ne rastet kur nga auditimi i brendshem ose nga struktura te tjera brenda subjektit zbulohen raste te mashtrimeve ose veprave penale ne dem te fondeve publike duke garantuar paraqitjen e tyre ne kohen e duhur ne prokurori

7.3.Certifikimi i llogarive publike.

Aktualisht ne te gjithë sistemin e KBFP, sherbimi i kontabilitetit paraqet nje hallke te dobët per shkak se mbikqyrja e tij nuk eshte ne vemendje te plote te menaxhimit dhe e strukturave tjera profesionale. Kjo vjen edhe per shkak se deklarata financiare dhe pasqyrat financiare te subjekteve publike nuk i nenshtrohen ndonje certifikimi nga profesioniste te kualifikuar. Ne menyre qe te rritet besimi ne permbajtjen e ketyre pasqyrave dhe vendimarrjet e menaxhereve mbi to te jene fektive, duhen ndermarre hapa per te ngritur nje sistem certifikimi te llogarive publike ne teresi dhe jo vetem te qendrave te shpenzimeve buxhetore. Opinioni i pjesshem i dhene nga ekspertet kontabel te autorizuar per subjekte publike qe ndjekin veprimtari biznesi nuk eshte i plote dhe nuk e kryen plotesisht misionin, nderkohe qe per qendrat e shpenzimeve buxhetore nje certifikim i tille nuk behet. Auditimi i brendshem nuk e ben rregullisht auditimin e deklaratave financiare por vetem pjese te vecanta te tyre nga ana tjeter misioni i tyre nuk perkon ne kohe me paraqitjen e ketyre deklaratave. Duke qene se certifikimi eshte nje kontroll ex-post, kryerja e tij nuk mund te jete pjese e punes se auditeve por ai i nenshtrohet vleresimit te auditeve si te gjithë elementet e tjere te sistemit te KBFP. Ne keto rrethana eshte e domosdoshme qe te behet certifikimi i deklaratave financiare ne nje nivel te caktuar (ndoshta jo nje certifikim i plote) nga inspektorët financiare apo trupa te tjere profesionale. Nje gje e tille do te ndihmonte edhe KLSH per te dhene opinione me te plota, lidhur me bilancin e konsoliduar te shtetit.

7.4.Zhvillimi i nje kuadri ligjor dhe procedural per investimet dhe auditimin e fondeve te BE dhe donacionet.

Nuk ka ndonje rregullim te vecante per investimet dhe financimet e huaja ne Shqiperi. Nje ligj per kete qellim vecanerisht per financimet e huaja eshte ne programet e Minsirise Financave per t'u pergaditur. Auditimi i financimeve te huaja nuk eshte i rregulluar me ligj. As KLSH dhe as strukturat e auditimit brendshem nuk kane mandat per te audituar keto fonde. Auditimi dhe rregullime te tjera te kontrollit brendshem behen ne kontraten perkatese te financimit duke caktuar edhe menyren e auditimit.

Ligji i ri per financimet e huaja qe do te plotesojë kuadrin e kontrollit per kete qellim duhet te synojë qe burimet financiare te huaja te deslinuara per t'u perdorur ne vendin tone, t'i nenshtrohet legjislacionit vendas. Ai duhet t'i jape

akses strukturave te auditimit, per auditimin e ketyre veprimtarive. Nje alternative e mundeshme konsiderohet perfshirja ne skemen e thesarit edhe per financimet e huaja, kredite etj.

Nderkohe procedura rigoroze ndjehet e e nevojshme te hartohen lidhur me perfshirjen e investimeve qe financohen nga buxheti i shtetit ose kur ai merr pjese si bashkfinancues me donatoret ne projekte, me qellim permiresimin e efektivitetit te ketyre investimeve dhe shmangien e ndikimit te autoritetit te c'faredo lloji per te disponuar mbi keto burime, jashte logjikes ekonomike.

7.5. Pergaditja e Ligjit per Financat e Pushtetit vendor.

Financat e pushtetit vendor aktualisht qeverisen mbi bazen e nje ligji te vitit 1993 ,ndryshuar ne vitin 1998 "Per buxhetin lokal". Nderkohe eshte hartuar strategjia e decentralizimit te qeverisjes vendore dhe progresi ne kete drejtim eshte i shpejte. Ligji aktual nuk mund te percjelle procesin e decentralizimit ne menyren se si eshte parashikuar. Ky proces duhet te shoqerohet domosdoshmerisht edhe me nje ligj qe te rregulloje financat e pushtetit vendor dhe kryesisht ne keto drejtime:

- ✓ Procedurat e buxhetimit lokal
- ✓ Procedurat e kredimarrjes dhe limitet perktese.
- ✓ Menaxhimi i shpenzimeve publike perfshi edhe auditimin e brendshem.
- ✓ Maredheniet me buxhetin qendror.

Procesi i decentralizimit financiar ne pushtetin vendor mund te kushtezohet edhe me plotesimin e disa standarteve te caktuara ne ligjin "Per financat e pushtetit vendor" dhe ky process mund te realizohet vetem ne se plotesohen standartet perkatese duke marre keshtu garancite e nevojshme paraprake per perdorimin efikas te burimeve publike.

7.6. Ngritja e Njesise Qendrore te Harmonizimit.

Per shkak te games se gjere te kontrollit brendshem ne sektorin publik dhe nevojës per te harmonizuar ate, eshte e nevojshme qe ne pershtatje me praktikat me te mira te vendeve europiane, te krijohet nje strukture e re e cila do te kete per mision harmonizimin e metodologjise se kontrollit brendshem financiar publik. Vendi i kesaj njesie mund te jete e vecante ose ne perberje te Drejtorise Pergjitheshme te Auditimit Brendshem. Misioni, pergjegjesite struktura organizative e kesaj njesie duhet te jene ne pershtatje me praktikat e vendeve tjera dhe kushtet e vendit tone. Ngritja e kesaj njesie eshte hapi i pare shume i rendesishem per implementimin e Leter Politikave dhe te planit te veprimit, madje ai mund te konsiderohet edhe si parakusht per implementimin e tij.

8. Konfliktet e interesave ne zhvillimin e KBFP

Pervec sa percaktohet ne nenin 37 te Kodit te Procedurave Administrative subjektet publike subjektet publike ne ndertimin e kontrolleve te brendeshme duhet te mbajne parasysh dhe te respektojne edhe kerkesat per konfliktin e interesave si vijon:

- ❑ Organi drejtues i subjektit publik ose individi qe ushtron funksione drejtuese nuk mund te nxjerre urdhera dhe njekohesisht te perfitoje prej tyre.
- ❑ Individi qe ushtron funksione drejtuese ne sektorin publik nuk mund te jete njekohesisht urdherues dhe ekzekutues i ketij urdheri.
- ❑ Individi qe ushtron funksione drejtuese ne sektorin publik nuk mund te jete njekohesisht regjistrues dhe ekzekutues i pagesave.
- ❑ Individi qe ngarkohet me ndertimin e kontroleve te brendeshme (hartimin e rregullave dhe procedurave) duhet te deklaroje paraprakisht me shkrim interesat e tij ne kete process.

9.Hartimi i planit veprimi per implementimin eKBFP ne Shqiperi.

Nje plan veprimi per implementimin e kuadrit teKBFP ne Shqiperi krahas shqyrtimit dhe miratimit te ketij dokumenti eshte i domosdoshem. Ky plan veprimi duhet te percaktoje minimalisht

- ❑ Hapat qe duhen hedhur per implementimin e plote te sistemit te KBFP
- ❑ Nje kuader ligjor dhe metodologjik baze per zhvillimin e KBFP
- ❑ Strukturat pergjegjese per implementimin e KBFP.
- ❑ Afatet per realizimin e te gjitha fazave.
- ❑ Strukturat monitoruese dhe raportimin

10.Kostoja e implementimit.

Implementimi i Leter Politikave dhe i Planit te Veprimit kerkon angazhimin e burimeve njerezore dhe financiare suplementare te konsiderueshme.Ky eshte nje process afat gjate dhe nje funksion i perhershem i sektorit publik prandaj disenjimi dhe implementimi i ketij funksioni eshte i nje rendesie te vecante. Burimet njerezore te perhershme qe parashikohet te anagazhohen ne Njesine Qendrore te Harmonizimit perfaqsohen nga nje numur i kufizuar personash por me nje kualifikim te larte (Jo me pak se pese persona) nderkohe si burime suplementare do te konsiderohen kapacitetet ekzistuese ne Ministrite e linjes te cilat do te bashkepunojne me kete Njesi .

Buxheti vjetor paraprak i kesaj strukture llogaritet ne rreth 20 milion leke ne vit. Projekti ekzistues CARDS qe eshte ne implementim ne Drejtorine e Pergjitheshme te Auditimit parashikon zhvillimin e disa elementeve te Kontrollit Brendshem Financiar Publik, vecanerisht ne vleresimin e nevojave per trainim pergaditjen e disa manualeve etj. Pas perfundimit te ketij projekti (Qershor 2006) parashikohet te sigurohet nje mbeshtetje tjeter nga donatoret (Bashkimi European projekti CARDS) ne shumen 1 milion Euro per te cilen eshte hartuar nje projekt paraprak nga Ministria e Financave dhe eshte paraqitur ne Komisionin European dhe ky i fundit e ka perfshire ne prioritetet per vitin 1996-1998.

Tirane me 17.05.2005

Arben MALAJ

MINISTER I FINANCAVE

KUPTIMI DHE PERMBAJTJA E KBFP

Kontrolli i brendshem si koncept eshte mjaft i gjere dhe perfshin nje game te madhe ceshtjesh. Ne vendin tone me funksione te kontrollit brendshem jane kuptuar funksionet e auditimit, te revizionit, shqyrtimit te veprimtarive financiare etj. nderkohe qe sipas standarteve nderkombetare ky koncept eshte shume me i gjere dhe krejt i ndryshem.

Kontrolli i brendshem ne kuptimin e standarteve nuk eshte nje veprim i shkeputur, nje aksion i nje njeriu apo i nje grupi njerzish qe kryhet brenda nje kohe te caktuar por ai eshte nje kompleks veprimesh, masash, organizimesh procedurash, qe kryhen nga te gjithë punonjesit e nje subjekti gjate gjithë kohes per te arritur objektivat e caktuara nga menaxhimi.

Me fjale te tjera kontrolli i brendshem jane njerezit, dhe veprimtaria e tyre, organizimet, asetet, programet, rregullat, procedurat, politikat e caktuara nga menaxhimi ne funksion te arritjes se objektiveve me kosto sa me te ulet duke ruajtur cilesine e nevojshme. Ne teresine e ketyre burimeve ben pjese edhe auditimi i brendshem si nje funksion i cili i jep keshilla menaxhimit per perdorimin e burimeve me efektivitet dhe eficence.

Ne kuptimin gjuhesor fjala "kontroll", ka dy kuptime; Ne te shumten e rasteve ka kuptimin, "kontrolloj situaten", "mbaj nen kontroll", "zoteroj", "vendos rregull" etj. ne menyre qe veprimet te rrjedhin sipas parashikimeve. Ne nje kuptim tjeter kjo fjale perdoret edhe ne kuptimin (check) "kontrolloj" qe nenkupton "verifikoj", "konstattoj" etj. gje e cila eshte krejt e ndryshme me fjalen "auditoj" qe eshte nje process qe perfshin shqyrtimin, analizen dhe vleresimin per ngjarje te caktuara, si dhe dhenien e rekomandimeve per permiresimin e veprimeve te nje subjekti.

1 Komponentet e KBFP

Sistemi i kontrollit dhe menaxhimit financiar, ndryshe i kontrollit brendshem perbehet kryesisht nga keta elementë kryesorë:

- Procedurat e buxhetit dhe të kontabilitetit të rregulluara nga ligjet perkatese mbi hartimin dhe zbatimin e Buxhetit, Ligji i Kontabilitetit.
- Procedurat e arshivimit dhe të dokumentimit te rregullura nga ligjet perkatese
- Kontrolli financiar ex-ante perfshin aktivitetet e kontrollit të nevojshem për të lejuar vendimet financiare të ndërmerren në lidhje me angazhimet, procedurat tenderiale, kontratat (angazhimet dytësore), dhe disbursimet përkatëse dhe rikuperimin e shumave të paguara padrejtësisht. Në përgjithësi kontrolli ex-ante zbatohet nga njesitë e kontrollit brenda qendrave të shpenzimit të buxhetit duke mbështetur vendimet financiare.
- Kontrolli Financiar ex-post siguron nëse sistemet administrative dhe kontabël funksionojnë në mënyrën e duhur, verifikojnë në nivelin e

përfituesit, përdorimin korrekt të fondeve publike, në përputhje me rregullat dhe rregulloret përkatëse.

- Aktivitet tjetër i kontrollit ex-post është certifikimi. Qëllimi i tij është të konstatojë se deklaratimet e shpenzimeve janë të sakta dhe të vërtetojë se këto deklarime rezultojnë nga sistemet e besueshme dhe të dokumentuara mirë të kontabilitetit të bazuara në dokumente të verifikueshme.

Trupa e certifikimit duhet të jete e pavarur nga qendra e shpenzimit të buxhetit jo vetëm në dukje por kjo duhet vërtetuar.

Detyrat kryesore të tij janë:

- ♦ Lëshimi i një certifikate mbi llogarinë vjetore të qendrave shpenzuese direkte për sa i përket integritetit, saktësisë dhe vërtetësisë së këtyre llogarive.
- ♦ Raportimi në baza vjetore mbi përshtatshmërinë e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të qendrave shpenzuese direkte.
- ♦ Verifikimi i ekzistencës dhe korrektësisë së elementit kombëtar bashkëfinansues.

2.Kontrolli i Brendshëm

Kontrolli i Brendshëm në përgjithësi mbulon të gjithë sistemin e kontrollit financiar dhe kontroleve të tjera (kontrollët kontabël dhe administrative) dhe përfshin strukturën organizative, metodat, procedurat si dhe auditimin e brendshëm të vendosur dhe mirëmbajtur nga menaxhimi. *“Kontrolli Brendshëm, është organizimi, politikat dhe procedurat e përdorura për të ndihmuar dhe për të siguruar drejtuesit, se programet e tyre po arrijnë rezultatet e synuara, se burimet e përdorura për të realizuar këto programe janë në përputhje me qëllimet dhe objektivat e subjektit publik, se programet e tyre janë të mbrojtura nga mashtrimet, harxhimet dhe keqmenaxhimet, dhe se informacioni i besueshëm është përfutur në kohë, është ruajtur, raportuar dhe përdorur drejt për vendim marrjen.”*

Sistemet e kontrollit të brendshëm financiar janë ato kontrole që kanë një përbërës financiar specifik. Ato mbulojnë kontrollin financiar ex ante (aprovimi paraprak), kontrollin e vazhdueshëm (on-going) dhe kontrollin financiar ex post dhe sigurojnë përdorimin korrekt të fondeve në përputhje me rregullat përkatëse.

3.Auditimi i Brendshëm

Auditimi i brendshëm është një aktivitet i pavarur, objektiv, këshillues dhe vlerësues, i hartuar që t'i japë vlerë dhe të përmirësojë veprimet e një subjekti. Ai e ndihmon subjektin që të përmbushë objektivat e tij duke përdorur një metodë sistematike, disiplinuese për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e menaxhimit të riskut, proceseve të kontrollit dhe atyre qeverisëse.

4.Dallimet midis sistemit te kontrollit brendshem,menaxhimit financiar dhe auditimit te brendshem

Duhet të pranojmë dallimet midis auditimit të brendshëm dhe menaxhimit financiar dhe sistemit të kontrollit. Menaxhimi financiar dhe sistemet e kontrollit janë përgjegjësia e menaxherit zbatues .Auditimi i brendshëm duke qene pjese e sistemit te kontrollit brendshem, vlerëson nëse këto përgjegjësi janë zbatuar sipas parimeve të menaxhimit financiar të fortë dhe informon menaxherin për zbulimet e tij dhe jep rekomandimet për të përmirësuar këto sisteme.

5.Njesia qendrore për zhvillimin dhe zbatimin e metodologjisë per menaxhimin financiar dhe auditimin e brendshem

Qëllimi i vendosjes së një trupi qendror është që t'i japë qeverisë një mjet për të siguruar se menaxhimi dhe kontrolli financiar si dhe standartet e auditit të brendshëm mbeten në linjë me standartet e pranura ndërkombëtare dhe standartet e pajtueshme të BE dhe ato pranohen nga auditët e brendshëm dhe menaximi në sektorin publik.

Njesia qendrore do të jetë përgjegjës për vendosjen e standarteve të harmonizuara dhe udhëzimeve të zakonshme mbi auditimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin. Ajo nxit zhvillimin e vazhdueshëm të përgjithshëm të sistemeve të cilësisë së lartë të KBFP. Ajo do të nxisë praktikën më të mirë për aplikimin e standarteve nëpërmjet seminareve,konferencave dhe punëve në grup dhe komunikimit të përgjithshëm, por jo më pak e rëndësishme, do të jete mbikqyrja ne se standartet dhe rregullat e vendosura ndicen dhe zbatohen. Pervoja me e mire eshte qe funksionet metodologjike te auditimit dhe te kontrollit brendshem te jene te ndara nga njera tjetra dhe te zhvillohen pavaresisht.

PARIME TE PERGJITHESHME DHE OBJEKTIVA PER IMPLEMENTIMIN E SISTEMIT TE KBFP.

1.Parimet e pergjitheshme

Kontrolli i brendshem ne sektorin publik duhet te mbeshtetet ne parimet e njohura te organizimit te tij si dhe ne standartet me te perparuara nderkombetare. Disa nga parimet mbi te cilat duhet te mbeshtetet dhe strukturohet kontrolli i brendshem ne te gjithe sektorin publik duhet te jene:

- **Ligjshmeria:** kontrolli i brendshem ne sektorin publik organizohet dhe funksionon ne baze te Kushtetutes dhe akteve ligjore e nenligjore ne fuqi.
- **Standartet:** aktet ligjore dhe nenligjore qe rregullojne veprimtarine e kontrollit te brendshem respektojne standartet nderkombetare dhe marreveshjet e ratifikuara nga Republika e Shqiperise.
- **Autorizimi:** transaksionet miratohen nga autoritetet pergjegjese ne pajtim me autoritetin e pergjithshem perpara se ato te regjistrohen.
- **Plotesia:** transaksionet e vlefshme duhet te jene te regjistruara ne regjistrat perkates te llogarise.
- **Vlefshmeria:**transaksionet e regjistruara duhet te paraqesin besnikerisht ngjarjet ekonomike te ndodhura, te ligjshme dhe te ekzekutuara ne pajtim me autorizimin e autoritetit pergjegjes.
- **Saktesia:** transaksionet e vlefshme duhet te jene te sakta, ne perputhje me informacionet e regjistruara ne menyre kronologjike.
- **Ruajtja dhe siguria fizike:** sigurimi qe asetet fizike dhe sistemet e informacionit jane te mbrojtura,te kontrolluara dhe te kufizuara per perdorim vetem per personelin e autorizuar.
- **Trajtimi i gabimit:** gabimet e zbuluara ne cdo hap te procedimit shoqerohen me veprime korrigjuese dhe raportohen ne nivelin perkates te drejtimit.
- **Ndarja e detyrave:** i njejti individ nuk mund te kete njekohesisht pergjegjesine e kontrollit, te regjistrimit dhe ate te kryerjes se transaksionit.

2.Objektivat strategjike te KBFP

Sigurimi i nje menaxhimi te fondeve publike ne perputhje me ekonomine efektiveitetin dhe eficensen dhe ngritja e nje kuadri te kontrollit financiar per te garatnuar kete menaxhim ne perputhje me kriteret e mesiperme.

3.Objektivat prioritare te KBFP

- ❑ Garantimi i ligjeshmerise,efektivitetit,eficenses dhe ekonomise ne procesin e ekzekutimit te buxhetit te shtetit dhe te perdorimit burimeve publike
- ❑ Ngritjen e nje kuadri ligjor te sistemit te KBFP
- ❑ Inkurajimi i permiresimit te mjedisit te kontrollit brendshem bazuar ne standartet nderkombetare te kontabilitetit,auditimit dhe zbatimi i arritjeve te teknologjise informacionit
- ❑ Forcimi i natyres parandaluese te kontrollit brendshem nepermjet theksimit te funksionit te kontrollit ex-ante.
- ❑ Zhvillim i i auditimit te brendshem si nje mjet i pavarur ,i perhershem dhe objektiv per permiresimin e veprimtarise se subjekteve publike dhe asistimin e tij ne procesin e arritjes se objektivave.
- ❑ Percaktimi i qarte i funksioneve te inspektimit per mbikqyrjen e buxhetit dhe shmangien e dublikimeve me auditimin e brendshem.
- ❑ Mbrojtjen e interesave financiare te shtetit dhe te organeve te pushtetit vendor dhe ne shoqerite me kapital shteteror.
- ❑ Mbrojtja e interesave te BE ne lidhje me financimin e projekteve dhe dhe te prgrameve me fondet e BE.
- ❑ Implementimi i rregullave dhe kontrolleve te brendshme duke perfshire rikuperimin e demeve nga shkeljet dhe parregullsitet ne lidhje me interesat e shtetit dhe te financimeve te BE.
- ❑ Performanca e politikave efektive per zhvillimin e burimeve njerezore ne kuadrin e KBFP
- ❑ Permiresimi ne teresi i sistemit te kontrollit dhe te prokurimit publik.
- ❑ Permiresimi i bashkepunimit midis institucioneve te ndryshem Brenda sistemit te KBFP dhe sigurimi i bashkepunimit efektiv me institucionet e BE .
- ❑ Parandalimin dhe zbulimin e gabimeve, parregullsive, shkeljeve ligjore dhe percaktimin e masave per korigjimin e tyre.
- ❑ Ruajtjen dhe perdorimin e burimeve financiare, materiale e njerezore me synim rritjen e frytshmerise se tyre.
- ❑ Pajtueshmerine e veprimeve me rregullat dhe te rezultateve me programet e parashikuara.
- ❑ Saktesine dhe plotesine e informacionit financiar e te drejtimit si dhe perdorimin e tyre ne procesin e vendimarrjes.

Kontrolli i brendshem i realizon objektivat nepermjet:

- ✓ Sigurimit te regjistrimit besnik dhe ne menyre te autorizuar te cdo transaksioni.
- ✓ Ndarjes se funksioneve dhe pergjegjesive.
- ✓ Verifikimit reciprok te detyrave
- ✓ Kufizimit te fuqive individuale ne vendimarrje
- ✓ Percaktimit te sakte te sistemit te neneshkrimeve dhe autorizimit te veprimeve.
- ✓ Qarkullimit besnik dhe ne kohe te informacionit.

ZHVILLIMI I METODLLOGJIVE TE VLERESIMIT TE RISKUT

Risku, është një rrezik i mundshëm që një ngjarje, veprim apo një mosveprim i caktuar, mund të rrezikojë arritjen e objektivave në sistem ose në një pjesë të tij, demtimin e asetëve dhe/ose imazhin e subjektit.

Vlerësimi i riskut, është një proces i përgjithshëm i identifikimit, parandalimit dhe kontrollimit të risqeve.

Vlerësimi i riskut është një nga funksionet kryesore të menaxhimit. Për të arritur objektivat e aktiviteteve të tyre, menaxheret duhet të jenë të bindur se proceset e vlerësimit të riskut po funksionojnë dhe janë të përputhshme me praktikën e mirë. Menaxhimi është përgjegjës për procedurat e vlerësimit të riskut dhe kontrollit të brendshëm të subjektit.

Kategoritë kryesore të riskut janë si më poshtë:

- Aktiviteti i riskut është një risk që del nga tiparet specifike të një aktiviteti apo tipike e një zone të aktivitetit
- Risku i kontrollit është një situatë në të cilën masat e kontrollit nuk funksionojnë apo nuk merren parasysh, apo një situatë ku masat e kontrollit mungojnë apo nuk janë të rinovuara.
- Risku i mbetur është niveli i mbetur i riskut pas futjes dhe zbatimit të masave të kontrollit të vendosura nga menaxhimi i subjektit, p.sh niveli i riskut i pranuar nga menaxherët e agjensisë të cilët duhet të jetë optimumi i raportit kosto përfitim.
- Risku i auditit i përfaqësohet si riksu i zbulimit, është një risk në të cilin edhe auditët e jashtëm dhe të brendshëm nuk zbulojnë gabime apo parregullsitë në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Objektivat kryesore të vlerësimit të riskut janë si më poshtë:

- Mbrojtja e interesave financiarë të vendit dhe komunitetit Evropian kundër shkeljes, shpërdorimit, dhunimit të ligjit dhe gabimeve.
- Sigurimi i përmbushjes së objektivave të subjektit,
- Mbrojtja e burimeve të subjektit.
- Sigurimi i saktësisë dhe dobisë së informacionit dhe disponibiliteti i tij ndaj personave që kanë lidhje me të.
- Sigurimi që zyrtarët, njësitë strukturore dhe subjektet janë të afta për të operuar në një situatë krize.

Vlerësimi i riskut është detyra e menaxhimit të subjektit, por risku mund të vlerësohet gjithashtu nga një auditor i brendshëm. Një auditor i brendshëm do të përdorë informacionin e siguruar nga menaxhimi në përgatitjen e planeve të auditit. Këto janë mundësi të ndryshme procedurale për drejtimin e vlerësimit të riskut, nga të cilat më të zakonshmet janë:

- ✓ Audit i brendshëm do të përdorë një listë të risqeve të identifikuara nga menaxhimi dhe vlerësimin e menaxhimit për planifikimin e punës së tij.

- ✓ Auditi i brendshëm do të drejtojë një procedurë të vlerësimit të riskut në agjensi, auditi i brendshëm do të ketë rolin e drejtimit të procedurës por nuk do të përfshihet në identifikimin dhe vlerësimin e riskut.
- ✓ Auditi i brendshëm do të vlerësojë riskun në mënyrë të pavarur, p.sh. do të identifikojë risqet dhe të japë një vlerësim subjektiv për to.

Kombinimet e opsioneve të mësiërme janë te mundura gjithashtu. Sa më i madh të jetë numri i niveleve të menaxhimit dhe aktiviteteve të mbuluara nga vlerësimi i riskut, aq më objektiv do të jetë rezultati.

Detyra kryesore e auditit të brendshëm është të japë një vlerësim dhe të analizojë ekzistencën e një sistemi të kontrollit të brendshëm, efikasitetin dhe përputhshmërinë e tij me kërkesat e vendosura në legjislacion. Që të bësh këtë detyrë dhe të planifikosh punën e tij ose të saj, auditi i brendshëm duhet vlerësojë risqet që mund të ndikojnë në efektivitetin e aktivitetit të subjektit dhe sistemit të tij të kontrollit të brendshëm dhe përmbushjen e objektivave të tij.

Identifikimi i riskut.

Risqet duhen identifikuar në dy nivele:

- ✓ në nivelin e subjektit (bazuar në strukturën organizative) dhe
- ✓ në nivelin e aktivitetit (bazuar në funksionet).

Në identifikimin e riskut duhet t'i kushtohet kujdes faktorëve të brendshëm të subjektit (sic është cilësia dhe motivimi i stafit, etj) dhe faktorët e jashtëm (sic është amendimi i ligjit, zhvillimet teknologjike, forca mëdha (fuqi mbnatyrore), etj). Ka disa metoda të identifikimit të riskut, por duhet t'i kushtohet vëmendje disa faktorëve si eksperiencia nga periudhat e mëparshme që kanë dështuar në arritjen e objektivave, rëndësia e një aktiviteti për subjektin etj.

Monitorimi i ndryshimeve në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm dhe menaxhimi i formave të riskut të lidhura me të, formojnë një pjesë të rëndësishme të procesit të identifikimit të riskut. Shumë vëmendje i duhet kushtuar gjithashtu ndryshimeve në mjedisin operues, punonjësve të rinj (aftësive të tyre, njohurive, kuptimit të kulturës organizative), sistemi i ri apo i ndryshuar i informacionit, zhvillimi i shpejtë i subjektit ose ndonjë nga njësitë strukturore të tij, legjislacioni i amenduar, etj.

Është e rëndësishme për një subjekt publik të identifikojë risqet që ekzistojnë në të tashmen dhe ato që mund të lindin në të ardhmen.

Megjithëse jo të gjitha risqet të cojnë detyrime në një risk të rëndë për aktivitetin e subjektit apo pozitën financiare, ka risqe që mund të kenë një ndikim serioz potencial në funksionimin efektiv të subjektit publik dhe situatës së tyre financiare.

Përveç identifikimit të riskut, është e nevojshme që t'i japim përparësi, faktit që menaxhimi të mund të fokusohet në heqjen apo reduktimin e risqeve të larta me mjetet dhe masat e duhura të kontrollit.

Analiza e Riskut

Analiza e riskut është një aktivitet sistematik që zbatohet në një mënyrë specifike për identifikimin e risqeve të lidhura me situatën nën analizë.

Shembuj për treguesit e përdorur në analizat e riskut janë:

- ✓ kuadri i vendosur i kontrollit
- ✓ ekzistenca dhe qartësia e rregullave të procedurave.

- ✓ Ndikimi i risqeve në publik
- ✓ Rëndësia e risqeve në termat financiare
- ✓ Niveli i aftësive të duhura dhe njohurive të stafit
- ✓ Volumi i transaksioneve

Në zgjedhjen e treguesve që janë bazat për një vlerësim, faktorët e brendshëm apo të jashtëm objektivë të pranishëm në situatën e dhënë duhet të merren parasysh gjithnjë.

Si rezultat i analizës së riskut, risqet e identifikuara kanë prioritet. Risqet duhet të vlerësohen rregullisht dhe ky vlerësim duhet të sigurohet nga kontrollët e brendshme dhe të rregullohet sipas ndryshimeve në faktorët që ndikojnë në mjedisin e riskut. Ky proces përfshin identifikimin e risqeve të shkaktuara, faktorët e brendshëm dhe të jashtëm dhe vendosjen e kriterëve për matjen e rrezikut që lind nga risqet e aktivitetit të agjencisë.

Menaxhimi i riskut.

Duke marrë parasysh faktorët e brendshëm dhe të jashtëm, duke përfshirë edhe ato që janë nën apo përtej kontrollit të subjektit, drejtuesi i subjektit duhet të marrë masa për menaxhimin e riskut i cili konsiston në:

- Përgatitjen e një politike për menaxhimin e riskut në të gjitha aktivitetet dhe nivelet.
- Zbatimi i një sistemi kontrolli të përshtatshëm për parandalimin, menaxhimin dhe nëse është e mundur për eliminimin e risqeve të identifikuara.
- Vendosja dhe zbatimi i procedurave të kontrollit të brendshëm
- Monitorimi i zbulimeve të auditit dhe kontrollit për identifikimin e gabimeve në kontroll dhe risqe të reja të mundshme si dhe koregjimin e tyre.
- Kontrolli ex-post i parregullsive, shkeljeve të ligjit, të identifikuara si rezultat i kontroleve dhe dhe zbatimit të procedurave të reja të kontrollit të brendshëm.
- Vlerësimi i vazhdueshëmi riskut, duke përfshirë monitorimin e nivelit të risqeve në mënyrë që të përcaktohen tendencat për ndodhjen e tij.
- Përgatitjen e një plani veprimi për rehabilitimin dhe rivendosjen e situatës pas vertetimit të riskut.

Shtojca Nr.4

MIREMBAJTJA DHE RISHIKIMI I KONTROLLIT BRENDSHËM

Pas përfundimit të vlerësimit të rrezikut për sejcilin funksion duhet të bëhet një rishikim i kontrollit të brendshëm në periudha dhe afate kohore të përshtatshme dhe të diferencuar sipas funksioneve të veprimtarive.

Rishikimi i kontrollit të brendshëm përfshin problemet e mëposhtme ose cilin do prej tyre.

- Vrojtimin dhe rivlerësimin e vendit të punës dhe të funksionit
- Intervistimin e të punësuarave me qëllim dokumentimin apo vlerësimin e proceseve të përfshira në ushtrimin e funksionit.
- Përkufizimin e synimeve që duhet të përmbushë kontrolli i brendshëm.
- Rishikimi i procedurave dhe dokumentacionit ekzistues
- Vlerësimin e rezultateve të punës për të vërtetuar nëse procedurat janë zbatuar dhe rezultatet janë në pajtim me planin.

Hollësitë e rishikimit të kontrollit të brendshëm ndryshojnë në pajtim me rëndësinë dhe kompleksitetin e funksioneve të ekzaminuara, vlerësimin dhe sensibilitetin e funksioneve dhe mjedisin ekzistues të kontrollit brendshëm në përgjithësi.

Rishikimi i kontrollit të brendshëm duhet t'u japë përgjigje disa pyetjeve themelore.

- Cilat janë synimet e funksionit të ekzaminuar, c'fare rezultatesh priten të realizohen dhe cilat janë problemet që duhen shmangur.
- C'fare hapash duhet të ndihen për të realizuar synimet e funksioneve të caktuara.
- Cilat janë dobesitë e kontrollit brendshëm që pengojnë përmbushjen e synimeve dhe objektivave. Në përgjigjen e kësaj pyetje duhet të evidentohet edhe teprica e kontroleve të brendshme të cilat bëhen pengesë për realizimin e programeve ose rritin koston e tij.
- Cilat janë hapat koregjues që duhen ndërmarrë për të minimizuar ose eliminuar dobesitë dhe cila është kostoja e tyre

ZHVILLIMI I KONCEPTIT TE GJURMËS SE AUDITIT

Koncepti i gjurmës së auditit nuk është i zhvilluar në vendin tonë por një zhvillim i tij kërkohej në kuadrin e ndërtimit të sistemit të KBFP.

Një gjurmë auditit është një mjet konceptual që i mundëson menaxherët dhe auditët që të kuptojnë lehtë sistemin e subjektit dhe funksionimin e proceseve në nivelet e ndryshme të tij. Një gjurmë auditit është një mjet i përdorur nga auditorët për të përshkruar zonën e mbuluar nga testimi i auditit. Është një set informacionesh që regjistron aktivitetet dhe ngjarjet që ndodhin në subjekt, në vecanti për lëvizjen e fondeve.

Informacioni i përfutur nga një gjurmë auditit i bën të mundur menaxherit apo auditit që të përcaktojë sekuencën e ngjarjeve në një proces. Një gjurmë auditit bën të mundur që të ndahet procesi në aktivitete individuale, për të identifikuar aktivitetet nga personat që i zbatojnë ato dhe nga personat që janë përgjegjës për to. Një informacion i tillë ju bën të mundur menaxherëve dhe auditëve që të vlerësojnë më mirë dhe më shpejt funksionimin e subjektit si një e tërë dhe proceset e tij themelore.

Duhet të tregohet kujdes kur të regjistrohet një gjurmë auditit që:

- Të bëhet dakord për simbolet standarte dhe t'i shpjegohen përdoruesve përpara se të përdoren nëpër regjistrime
- Informacioni i rëndësishëm mbi një proces duhet të shkruhet brenda simboleve.
- Pjesa e tekstit duhet të jetë sa më e shkurtër të jetë e mundur që të merret një ide e përgjithshme e qartë.
- Përshkrimet e proceseve duhet të jenë të plota dhe gjurma e auditit nuk duhet të ndërpritet në ndonjë vend.
- Nëse procesi që po regjistrohet nuk mund të skicohet në një faqe, procesi duhet ndarë në nënprocese logjike, të cilat duhet të kenë lidhje.
- Regjistrimi duhet të jetë konsistent dhe lëvizjet duhet të bëhen nga lart poshtë dhe nga majtas djathtas ashtu siç është rënë dakord.

Kerkesat e mesiperme janë të domosdoshme të mbahen parasysh në ndërtimin e kontrolleve të brendshme dhe në krejt sistemin e KBFP.

**PERGJEGJESITE E DETAJUARA TE STRUKTURAVE PUBLIKE NE KUADER
TE KBFP**

Pergjegjësia per sistemin e kontrollit brendshem

Cdo punonjes ne subjekt ka nje rol te caktuar per kontrollin e brendshem. Cdo individ brenda njesise eshte pergjegjes per ate qe eshte i vetedijshem per procedurat e kontrollit brendshem lidhur me pergjegjesite e tij ne postin e punes.

Kontrolli i brendshem eshte jo vetem nje process i procedurave dhe politikave te menaxhimit por ai eshte thellesisht i ndikuar nga njerezit. Kontrolli i brendshem ne raport me njerezit eshte nje "reaksion zinxhir" dhe nje process reversiber. Eshte i tille per faktin se kontrolli i brendshem ndikohet nga njerezit, ashtu si procesi i implementimit te tij eshte nje process qe realizohet teresisht me pjesmarrjen e njerezve si dhe koregjimet e vazhdueshme qe i behen ketij procesi ndikohen drejperdrejt nga njerezit. Nga ana tjeter ai ndikon mbi njerezit qe te kryejne veprimet ne perputhje me rregullat procedurat dhe politikat e menaxhimit. Ne kuptimin me te gjere te fjales kontrolli i brendshem brenda subjektit eshte pergjegjesi e gjithë njerezve qe marrin pjese ne veprimtarine e ketij subjekti. Por ashtu si pjesmarrja ne veprimtari dhe intensiteti i saj eshte i ndryshem edhe pergjegjësia e njerezve eshte e ndryshme dhe ndikohet drejtperdrejte nga rolet dhe pergjegjesite e individeve ne subjekt. Por rolet ndryshojne ne varesi te nivelit te pergjegjësise dhe te natyres se perfshirjes ne te nga individi.

Keto nivele e pergjegjësise jane te percaktuara ne strukturen organizative te subjektit. Ne kete kuptim nje lidhje e dobet ose nje linje e paqarte autoriteti ne strukturen organizative mund te krijoje nje dobesi ose carje ne sistemin e kontrollit. Duke ndjekur kete linje arsyetimi pergjegjësia per kontrollin e brendshem ndjek linjen e organizimit te subjektit. Sa me lart te jete individi ne piramiden e organizimit aq me e madhe eshte pergjegjësia e tij per kontrollin e brendshem. Ne nje fare menyre ekziston nje proporcion i zhdrejte midis angazhimit dhe perfshirjes se njerezve ne kontrollin e brendshem me pergjegjësine per kete kontroll. Keshtu duke ju referuar piramides se organizimit, ne bazen e saj jane te vendosur masa e gjere e te punesuarve dhe mbi to shtresohen nivelet e menaxhimit deri te menaxhimi me i larte. Ne se drejtperdrejt kemi nje perfshirje me te madhe te punonjesve dhe te niveleve te uleta te menaxhimit ne sistemin e kontrollit brendshem, pergjegjësia e tyre eshte me e vogel sa me afer bazes se piramides te jene te vendosur dhe kjo pergjegjësia rritet gradualisht ne proporcion me ngjitjen e shkalleve te pirmaides nga nivelet e menaxhimit.

Menaxheri kryesor se bashku me zevendsat e tij dhe administratoret e tjere jane pergjegjes per vendosjen e...

- ✓ Integritetit
- ✓ Etikes
- ✓ Kompetences dhe

✓ Nje ambineti kontrolli pozitiv

Gjithashtu menaxheri kryesor se bashku me zevendsat dhe administratoret e tjere jane pergjegjes per vendosjen e politikave kryesore te veprimit qe formojne themelin e nje sistemi kontrolli. Menaxheret dhe personeli tjeter mbikqyres jane pergjegjes per ekzekutimin e procedurave dhe politikave te kontrollit ne nivele te detajuara brenda njesise specifike te tyre.

Si konkluzion:

Kontrolli i brendshem eshte pergjegjesi e menaxhimit ne te gjitha nivelet. Menaxhimi eshte pergjegjes per: "ngritjen e kontrolleve te brendshem te besueshme qe sigurojne realizimin e veprimtarise se subjektit publik ne perputhje me Kushtetuten dhe legjislacionin ne fuqi dhe realizimin e programeve dhe objektivave me efektivitet, eficence dhe ekonomicitet."

Kuadri i KBFP kerkon te rregulloje jo vetem institucionet brenda skemes (juridiksionit) te Qeverise por edhe ato te pushtetit vendor dhe te institucioneve te pavarura. Keshtu qe eshte i nevojshem nje rregullim ligjor nga Kuvendi i Shqiperise me ane te nje ligji, i cili te shkallezoje pergjegjesite ne nivel funksional dhe operacional si me poshte:

Keshilli i Ministrave eshte pergjegjes per:

1. Percaktimin e nje politike te njesuar per plotesine dhe vlerat etike te nepunesve te sektorit publik, per pranimin, pergatitjen profesionale, vleresimin dhe nxitjen e tyre.

2. Ndarjen dhe delegimin e pergjegjesive midis tij dhe ministrive dhe institucioneve qendrore dhe organeve te pushtetit vendor.

3. Percaktimin dhe mbikqyrjen e objektivave dhe kontrollin administrativ per ministrite dhe institucionet qendrore ne vartesi te tij.

4. Percaktimin e rregullave te njesuara ne sektorin publik per pranimin ne pune me pergjegjesi materiale dhe financiare, per dokumentimin e veprimeve ekonomike e financiare, per inventarizimin dhe levizjen e vlerave materiale e monetare, per veprimet ne likuiditete, per format dhe rregullat e pagesave, per dokumentimin e punes e pagave.

Keshilli i Ministrave, per te realizuar pergjegjesite e veta, nxjerr vendime , me propozim te Ministrise se Financave.

Pergjegjesite e Ministrise se Financave

Ministria e Financave eshte pergjegjese per percaktimin e rregullave te njesuara:

1. Per organizimin dhe funksionimin e kontrollit te brendshem financiar ne sektorin publik ne nivel funksional.

2. Percaktimin dhe zbatimin e politikave, rregullave dhe metodologjive lidhur me kontrollet e tjera financiare dhe jo financiare brenda juridiksionit saj ne nivel qendror.

3. Per administrimin e buxhetit dhe inspektimin e tij ne te gjitha fazat e perhgaditjes dhe zbatimit.

4. Per veprimet e thesarit,

5.Per sistemin e kontabilitetit dhe vecanerisht kontabilitetin publik.

6.Per nje metodologji te njehesuar dhe adoptimin e standarteve nderkombetare per kontrollin e brendshem financiar publik.

Keshilli i Ministrave nxjerr vendime, dhe udhezime me propozim te Ministrise se Financave per zbatimin e pergjegjesive te mesiperme.

Pergjegjesite e ministrive dhe subjekteve te tjera publike

Kontrolli i brendshem financiar dhe kontrollet e tjera jane pergjegjesi ekskluzive e ministrit dhe titullarit te subjektit publik. Ai eshte pergjegjes per ngritjen e nje kuadri te kontrollit brendshem te besueshem ne subjektin qe drejton..

Pervec sa me siper ato jane pergjegjes edhe per:

1.Per organizimin e kontrollit brendshem financiar ne linjen e menaxhimit tyre.

2.Percaktimin dhe zbatimin e politikave, rregullave dhe metodologjive lidhur me kontrollet e tjera jo financiare brenda juridiksionit tyre dhe ne zbatim te metodologjive te nxjerra nga njesia qendrore e Ministrise Financave.

3.Percaktimin e pergjegjesive te funksioneve, vleresimin dhe verifikimin e plotesise te vlerave etike dhe profesionale te punonjesve si dhe pershkrimin e vendeve te punes.

4.Percaktimin e rregullave baze per qarkullimin e informacionit dhe te urdherave.

5.Per vlersimin identifikimin analizen dhe menaxhimin e zbulimin, e risqeve ne lidhje me arritjen e objektive te kontrollit te brendshem dhe perdorimin efikas te burimeve publike.

6.Percaktimin e rregullave baze qarkullimin dhe dokumentimin e vlerave materiale e financiare,dokumentimin e punes dhe te pagave, ruajtjen e aseteve nga rreziket e brendshme e te jashtme.

7.Analizen e raporteve te auditimit dhe zbatimin e rekomandimeve perkatese per permiresimin e procedurave te kontrollit te brendshem.

8.Subjektet e tjera publike jane pergjegjese per zbatimin e detyrave te percaktuara nga ministria apo institucioni qendror si dhe per percaktimin e rregullave baze e procedurave ne nivel operacional.

PLAN VEPRIMI

**PER IMPLEMENTIMIN E LETER POLITIKAVE "PER KONTROLLIN E
BRENDSEHM FINANCIAR PUBLIK"**

N r.	VEPRIMTARITE	A F A T I	STRUKTURA PERGJEGJESE	MONITORIMI
I	KRIJIMI DHE FORCIMI I KAPACITETIT INSTITUCIONAL			
1.	Krijimi i Njesise Qendrore te Harmonizimit Metodologjise se KBFP	Shtator 2005	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
2	Pergaditja e pershkrimet funksional dhe e strukture organizative te Njesise Qendrore te Harmonizimit	Tetor 2005	Njesia Qendrore e Harmonizimit	Ministria e Financave
3	Evidentimi i nevojave per trainim per personelin e sherbimeve financiare	Dhjetor 2005	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
4.	Pergaditja e programeve te trainimit.	Mars 2006	NJ.Q.H.	Ministria e Financave
5	Pergaditja e kriterave unike per rekrutimin dhe punesimin e punonjesve te sherbimeve financiare, ne formen e nje projekt vendimi te KM	Janar 2006	NJ.Q.H.	Keshilli i Ministrave
6	Pergaditja e ndryshimeve ligjore lidhur me shmangien e mbivendosjeve dhe forcimin pavaresise se Auditeve te Brendshem	Tetor 2005	Dr.Pergj.Auditimit Brendshem	Keshilli i Ministrave
7	Pergaditja ne formen e nje PV per KM per detyrat dhe pergjegjsite e te drejta te Shefit te sherbimeve financiare.	Dhjetor 2005	NJ.Q.H.	Keshilli i Ministrave
8	Krijimi i Inspektoriatit Financiar	Janar 2006	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
II	KRIJIMI DHE PERMIRESIMI I KUADRIT LIGJOR DHE METODOLLOJIK.			
1	Hartimi i P/Ligjit Per Kontrollin e Brendshem Financiar Publik.	Mars 2006	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
2	Pergaditja e Manualit te Kontrollit Financiar.	Tetor 2006	NJ.Q.H.	Ministria e Financave
3	Hartimi i nje P/VKM per shpembimet administrative	Dhjetor 2005	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
4	Permirsimi i Manualit te Auditimit Brendshem	Qershor 2006	Dr.Pergj.Auditimit	Ministria e Financave
5	Pergaditja e Ligjit per Financat e Pushtetit Vendor	Qershor 2006	MoF&MPVD	Keshilli i Ministrave
6	Hartimi i manualit te buxhetimit	Tetor 2006	NJ.Q.H.	Ministria e Financave
7	Zhvillimi i procedurave per vleresimin e rrezikut	Dhjetor 2006	NJ.Q.H.	Ministria e Financave
8	Hartimi i dispozitave lidhur me pergjegjesine financiare dhe rikuperimin e demeve	Mars 2006	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
9	Zhvillimi i procedurave dhe pergjegjesive per certifikimin e llogarive publike.	Nendor 2006	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
10	Zhvillimi i kuadrit ligjor per investimet publike dhe kontrollin e financimeve te huaja dhe donacioneve	Qershor 2006	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
11	Zhvillimi i nje kuadri te plote procedural per te ardhurat dytesore.	Mars 2006	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
12	Zhvillimi i manualeve te kontrollit financiar sipas MoL.	Dhjetor 2006	NJ.Q.H.	Ministria e Financave
13	Zhvillimi i procedurave per qarkullimin dhe dokumentimin e vlerave materiale e monetare	Qershor 2006	NJ.Q.H.	Ministria e Financave
14	Zhvillimi i nje programi trainimi per punonjesit e sherbimeve financiare	Qershor 2006- Qershor 2007	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
15	Informatizimi i sherbimit te kontabilitetit ne subjektete publike	Dhjetor 2007	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
16	Standartizimi i dokumentave baze te kontabilitetit	Qershor 2007	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
17	Pergaditja e procedurave dhe krijimi i kapaciteteve per certifikimin ogarive publike	Qershor 2006	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave

PLAN VEPRIMI

**PER IMPLEMENTIMIN E LETER POLITIKAVE "PER KONTROLLIN E
BRENDSEHM FINANCIAR PUBLIK"**

N r.	VEPRIMTARITE	A F A T I	STRUKTURA PERGJEGJESE	MONITORIMI
I	KRIJIMI DHE FORCIMI I KAPACITETIT INSTITUCIONAL			
1.	Krijimi i Njesise Qendrore te Harmonizimit Metodologjise se KBFP	Shtator 2005	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
2	Pergaditja e pershkrimtit funksional dhe e struktures organizative te Njesise Qendrore te Harmonizimit	Tetor 2005	Njesia Qendrore e Harmonizimit	Ministria e Financave
3	Evidentimi i nevojave per trainim per personelin e sherbimeve financiare	Dhjetor 2005	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
4.	Pergaditja e programeve te trainimit.	Mars 2006	NJ.Q.H.	Ministria e Financave
5	Pergaditja e kriterave unike per rekrutimin dhe punesimin e punonjesve te sherbimeve financiare, ne formen e nje projekt vendimi te KM	Janar 2006	NJ.Q.H.	Keshilli i Ministrave
6	Pergaditja e ndryshimeve ligjore lidhur me shmangien e mbivendosjeve dhe forcimin pavaresise se Auditeve te Brendshem	Tetor 2005	Dr.Pergj.Auditimit Brendshem	Keshilli i Ministrave
7	Pergaditja ne formen e nje PV per KM per detyrat dhe pergjegjsite e te drejtat e Shefit te sherbimeve financiare.	Dhjetor 2005	NJ.Q.H.	Keshilli i Ministrave
8	Krijimi i Inspektopriatit Financiar	Janar 2006	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
II	KRIJIMI DHE PERMIRESIMI I KUADRIT LIGJOR DHE METODOLLOJIK.			
1	Hartimi i P/Ligjit Per Kontrollin e Brendshem Financiar Publik.	Mars 2006	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
2	Pergaditja e Manualit te Kontrollit Financiar.	Tetor 2006	NJ.Q.H.	Ministria e Financave

3	Hartimi i nje P/VKM per shpenzimet administrative	Dhjetor 2005	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
4	Permiresimi i Manualit te Auditimit Brendshem	Qershor 2006	Dr.Pergj.Auditimit	Ministria e Financave
5	Pergaditja e Ligjit per Financat e Pushtetit Vendor	Qershor 2006	MoF&MPVD	Keshilli i Ministrave
6	Hartimi i manualit te buxhetimit	Tetor 2006	NJ.Q.H.	Ministria e Financave
7	Zhvillimi i procedurave per vleresimin e rrezikut	Dhjetor 2006	NJ.Q.H.	Ministria e Financave
8	Hartimi i dispozitave lidhur me pergjegjesine financiare dhe rikuperimin e demeve	Mars 2006	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
9	Zhvillimi i procedurave dhe pergjegjesive per certifikimin e llogarive publike.	Nendor 2006	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
10	Zhvillimi i kuadrit ligjor per investimet publike dhe kontrollin e financimeve te huaja dhe donacioneve	Qershor 2006	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
11	Zhvillimi i nje kuadri te plote procedural per te ardhurat dytesore.	Mars 2006	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
12	Zhvillimi i manualeve te kontrollit financiar sipas MoL.	Dhjetor 2006	NJ.Q.H.	Ministria e Financave
13	Zhvillimi i procedurave per qarkullimin dhe dokumentimin e vlerave materiale e monetare	Qershor 2006	NJ.Q.H.	Ministria e Financave
14	Zhvillimi i nje programi trainimi per punonjesit e sherbimeve financiare	Qershor 2006- Qershor 2007	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
15	Informatizimi i sherbimit te kontabilitetit ne subjektete publike	Dhjetor 2007	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
16	Standartizimi i dokumentave baze te kontabilitetit	Qershor 2007	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave
17	Pergaditja e procedurave dhe krijimi i kapaciteteve per certifikimin e llogarive publike	Qershor 2006	Ministria e Financave	Keshilli i Ministrave

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 4.6.2010

Doli nga shtypi më 6.6.2010

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë